



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



KOMUNA E KLINËS  
KUVENDI I KOMUNËS  
01.NR. 06 - 6026/15  
KLINË, 30.10.2015

### EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

TË SEANCËS SË IX-të TË KK, MBAJTUR, MË 30.10.2015, NË ORËN 10.00,  
NË SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryetari i komunës, Sokol Bashota, kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, nënkyetari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e Kuvendit (27), drejtorë të drejtive, Komandanti i Policisë, Rexhë Berisha, Zyra ligjore, Zyra e Auditimit, KFOR-i, OSBE, OJQ "Koha", Zyra për Barazi Gjinore, mediet etj.

Seancën e hapi kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe iu uroj mirëseardhje në këtë seancë të rregullt të KK-së. "Materialin e keni marrë me kohë, hapi diskutimin rreth rendit të propozuar të ditës".

Skënder Merturi, tha se propozoi që pika e 8 e rendit të ditës në kalojë në pikën 3, pas pikës së rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Kryesuesi Ibishi, sqaroi se edhe për këtë seancë le të shkojë kjo renditje e pikave të rendit të ditës, në seancat e radhës do të dakordohemi me shefat e grupeve kuvendare dhe do të vendosim. "Prandaj, për këtë seancë të jetë kështu", shtoi Kryesuesi. Kryesuesi vuri në miratim rendin e propozuar të ditës.

Me vota unanime u miratua ky

### RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për ndryshimet dhe plotësimet e PZHK për periudhën 2014-2021,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për vënien në diskutim publik të ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba komunale,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për vënien në diskutim publik të ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për Caktimin e Tatimit për Pronën e Paluajtshme të vitit 2016,
6. Interpelanca e drejtorit të Arsimit – kërkuar nga GP i LDK-së,
7. Shqyrtimi i rekomandimeve të KPF-së, dt. 19.10.2015,
8. Propozimi i Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimit për emërtimin e Palestrës Sportive me emrin e Komandantit Legjendar Adem Jashari.
9. Pyetje dhe përgjigje nga anëtarët e KK-së.

### **Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.**

Kryesuesi sqaroi se nuk ka mungesa të anëtarëve.

### **Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.**

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit të seancës së kaluar. Nuk pati debate. Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

### **Me vota unanime u miratua procesverbal i seancës së kaluar.**

### **Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për ndryshimet dhe plotësimet e PZHK për periudhën 2014-2021.**

Kryesuesi Dr. Ibishi foli rreth pikës në rend të ditës. "Këtë pikë të rendit të ditës e kemi kaluar më unanimitet të plotë në KPF. Është bërë fjalë për dy ngastra kadastrale që duhet të ndryshohen, për kishën në Deiq dhe xhaminë në Këpuz. Në KPF kemi kaluar si preferencë që ky Kuvend ta shqyrtojë dhe miratojë. Hapi diskutimin", tha Kryesuesi.

**Skënder Merturi**, theksoi se duhet ta kemi një rregullore. "Pajtohem dhe kam votuar për dhënien e tokës për kishën dhe xhaminë, por ajo çfarë po insistoj është për herë të tretë që të merret iniciativa që ta mungon kjo rregullore, pastaj po na dalin këto probleme që na kanë dalë tash. Zyra ligjore duhet ta hartojë një rregullore që kanë komunat tjera për këtë çështje. Nuk na kishte qitur në dilemë dilemat që i kemi pasur sikur të kishte ekzistuar ajo rregullore. Është mirë ta kemi një rregullore për këtë punë", shtoi anëtarë Merturi.

Kryesuesi vuri në miratim Propozim-vendimin për ndryshimet dhe plotësimet e PZHK për periudhën 2014-2021.

### **Me vota unanime u miratua propozim - vendimi.**

### **Pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për vënien në diskutim publik të ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba komunale.**

**Haxhi Ibishi**, theksoi se kjo është si një procedurë, ne e kemi konsumuar debatin edhe në KPF dhe është rekomanduar që të vihet në diskutim publik kjo rregullore, për arsy se thjesht janë procedura, vendosja e taksave ose shqyrtimi i taksave, gjobave dhe të hyrave të tjera komunale. Pra, është një rregullativë, e cila vazhdimisht për çdo vit kalon nëpër procedura.

Në vijim Kryesuesi hapi diskutimin. Nuk pati debate. Kryesuesi vuri në miratim propozim-vendimin.

### **Me vota unanime u miratua propozim-vendimi.**

### **Pika e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për vënien në diskutim publik të ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për Caktimin e Tatimit për pronën e Paluajtshme të vitit 2016.**

Kryesuesi Ibishi foli rreth rendit të ditës. "Drejtoria përkatëse na ka sjellë një propozim, ku mendon që duhet të ndryshohen këto, pastaj do ta kemi diskutimin publik, ndërsa në seancën e nëntorit do ta vëmë për diskutim dhe miratim këtu në Kuvend", shtoi Kryesuesi, i cili më pastaj fjalën e barti te zyrtari i lartë i Zyrës ligjore, z. Ali Shala.

**Ali Shala**, zyrtar i lartë i Zyrës ligjore, sqaroi çështjen në debatim. “Është fjala për një iniciativë që ka dhënë Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores të mëparshme të vitit 2007 që kemi pasur në fuqi për caktimin e tatimit në pronën e paluajtshme. Në bazë të variantit që ka dhënë Drejtoria për FEZH dhe në bazë të përcaktimeve ligjore që kemi nxjerrë ne, është fjala për ndryshime përbajtjesore për më tepër se 60% të tekstit të rregullores së mëparshme, duke i pasur parasysh edhe ndryshimet e mëvonshme ligjore. Prandaj këtu shkohet në hartimin e rregullores komplet për caktimin e tatimit të pronës së paluajtshme me këto ndryshime ligjore, se është përcaktim ligjor, se kur ndryshohet mbi 60% e tekstit shkohet në variantin e krejt rregullores. Kështu që, edhe këshilltarët edhe gjitha strukturat që e implementojnë këtë rregullativë, në procedurat e ardhshme do ta kenë rastin ta shqyrtojmë dhe e miratojmë”, sqaroi zyrtari Shala.

**Vlora Tafilaj**, theksoi se desha për t’ju bashkëngjitur fjalës së Skënder Merturit, se do të kishte qenë mirë që sa më parë të bëhet ajo rregullore dhe nuk e di nëse Komuna është duke kontribuar në regjistrimin e pronave si të atyre të paluajtshme, po ashtu edhe të këtyre parcelave që po jepen në shfrytëzim. Pra, sa është duke u bërë rreth regjistrimit të pronave? - shtoi anëtarja Tafilaj.

**Ali Shala**, sqaroi çështjen e ngritur nga anëtarët rreth hartimit të një rregulloreje të tillë. “Nuk kemi nevojë për rregullore të këtillë, sepse kemi ligjin. Pasi që ekziston ligji rreth çështjes në shqyrtim, nuk ka nevojë Komuna të nxjerr një rregullativë të tillë”, sqaroi zyrtari Shala.

**Pjetër Coli**, theksoi se edhe pse ekziston kjo rregullore, do të ishte e nevojshme që të bëhet një listë e pronave. “Komisioni nuk ka listë të veçantë që mund të di se cilat prona janë publike apo cilat janë shoqërore. Të bëhet lista e pronave,” shtoi anëtar Coli.

**Haxhi Ibishi**, foli rreth çështjes tematike. “Ligji është mbi çdo rregullativë”, shtoi Kryesuesi.

**Ali Shala**, foli rreth çështjes në shqyrtim. “Sa i përket çështjes së nxjerrjes së Rregullores për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës komunale, nuk ka nevojë, sepse, siç potencova edhe më lart, kemi ligjin, e kemi edhe Rregulloren e Qeverisë, që i ka të specifikuara të gjitha parimet ligjore. Ato komuna që kanë nxjerrë atë rregullore nuk di mbi çfarë baze e kanë nxjerrë, por unë në bazë të konsultimeve që kemi pasur me nivelin e ministrisë përkatëse na është sugjeruar se pushteti lokal nuk ka nevojë për të nxjerrë një rregullativë të tillë, përvèç që për të bërë përshtakimin e Ligjit edhe të Rregullores së Qeverisë. Unë konsideroj që nuk ka nevojë për një rregullativë të tillë”, sqaroi zyrtari Shala”, shtoi zyrtari Shala.

**Pjetër Coli**, tha se unë mendoj se edhe pse ekziston kjo rregullore do të kishte qenë mirë që të bëhet një listë e këtyre pronave që ta kemi në dispozicion dhe komisionet, si p.sh. Komisioni për pronën, ku jam edhe unë anëtar. “Kur vinë kërkesa të tillë ne nuk kemi qasje cilat prona janë pronë shoqërore, apo cilat janë publike. Do të kishte qenë mirë që të përpilohet një listë që ne si asamble ta kemi edhe si komision që të mos kërkojmë ne te organet kompetente të administratës së Komunës këtu, se cilat janë. Të përpilohet lista dhe atë listë ta ketë komisioni dhe mendoj që dukshëm shkurtohen procedurat po që se bëhet kjo listë”, shtoi anëtar Coli.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se mendoj që ligji është mbi çdo rregullore dhe kur ekziston Ligji për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës janë çështje që ne duhet t’i nënshتروhem”, nënvizoi Kryesuesi.

**Ali Shala**, sqaroi se nëse ju kujtohet edhe këshilltarëve edhe Nënkyetarit edhe ju si Kryesues, edhe komiteteve tjera, disa herë me radhë në asambletë e mëparshme kam këruar që të hartojet një regjistër i pronës së paluajtshme, tokën, banesat edhe lokalet. Duhet të ekzistojë një regjistër i tillë për shkak se ia lehtëson punën edhe komisionit i cili po vendos gabimisht. Unë isha në dijeni që para 2-3 ditëve pa prezencën e Zyrës Ligjore është mbajtur një takim dhe janë shqyrtuar disa kërkesa. Prona komunale në shfrytëzim nuk jepet me kërkesë të personave juridikë dhe fizikë, por është në iniciativë në rrugën ekskluzivisht zyrtare, ku kryetari i Komunës e jep propozimin paraprak. Ne i kemi dhënë këto sqarime,

prandaj ato kërkesa që i kanë pasur në miratim të gjitha refuzohen, përderisa nuk ka një ankand, një procedurë të rregullt për dhënien në shfrytëzim”, sqaroi zyrtari Shala.

**Enver Berisha** (nënkyretar i Komunës), foli rrëth çështjes në debat. “Në takimin me Bordin e drejtoreve, me vendim të Kryetarit, kemi formuar një komision që ka pasur për obligim regjistrimin dhe evidentimin e pronave komunale dhe ai komision e ka kryer punën e vet. Tashmë e kemi listën përfundimtare të pronës publike dhe komunale dhe në një të ardhme kur ta vlerësoni edhe ju si asamble mund ta keni atë listë përfundimtare”, shtoi nënkyretari Berisha.

**Haxhi Ibishi**, tha se është mirë që secili anëtar i KK, por edhe qytetarët të kenë qasje në ato prona, si informacion.

**Fadil Gashi**, tha se duhet sqaruar çështjen. “Ne patëm një propozim prej zyrtarit ligjor. Nëse është hartim i ri, meqë ka ndryshime për 60 për qind qysh po thuhet, ne nuk mund të marrim vendim vec për ndryshim, por për hartim të rregullores, pra automatikisht na obligon për të ndërtuar edhe komisione. Nëse duam për ta vënë si hartim të ri të rregullores, duhet sjellë vendim për hartim, por jo për ndryshim. Vetëm ta definojmë çështjen: a shkojmë me hartim apo ndryshim? Nëse shkojmë me hartim, është obligative për të përzgjedhur përnjëherë edhe komisionin që harton rregulloren,” shtoi anëtari Gashi.

**Haxhi Ibishi**, pyeti anëtarët si të procedohet, si hartim të rregullores apo vetëm si ndryshime të propozuara?

**Ali Shala**, sqaroi çështjen. “Duhet të shkojmë si hartim, me ndryshime dhe plotësimë”, sqaroi zyrtari Shala.

**Kryesuesi Ibishi**, vuri në miratim propozim-vendimin për hartimin dhe plotësimin e Projekt-rregullores për Pronën e Paluajtshme që kemi prej 2007, që do të thotë me ndryshime të propozuara.

### **Propozim-vendimi u miratua me vota unanime.**

Në vijim u formua komisioni për hartimin e Projekt-rregullores, i cili komision bashkë me Zyrën Ligjore do të hartojë Rregulloren me propozime e ndryshime për caktimin e Tatimit për Pronën e Paluajtshme.

Kryesuesi propozoi që çelësi i komisionit duhet jetë prej 5 anëtarë, 3 prej Kuvendit dhe 2 nga ekzekutivi. Domethënë komisioni të ketë përbërjen 3+2. Kryesuesi e vuri në miratim çelësin e komisionit.

### **Me vota unanime u miratua propozimi që komisioni të ketë 5 anëtarë.**

### **Komisioni u propozua me këtë përbërje:**

1. Rasim Millaku
2. Arben Limani
3. Vlora Tafilaj
4. Miftar Krasniqi
5. Driton Raci

Kryesuesi vuri në miratim emrat e komisionit të propozuar.

### **Përbërja e komisionit të lartshënuar u miratua me vota unanime.**

Kryesuesi foli rrëth çështjes në shqyrtim. Hapi debatin rrëth Propozim-vendimit për vënien në diskutim publik të ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për Caktimin e Tatimit për Pronën e Paluajtshme të vitit 2007. Nga ana e anëtarëve nuk pati debate. Kryesuesi vuri në miratim propozimin.

### **Propozimi u miratua me vota unanime.**

**Pika e gjashtë: Interpelanca e drejtorit të DKA-së – kërkuar nga Grupi i Kuvendarëve të LDK-së.**

**Kryesuesi foli rrreth çështjes. Fjalën e barti te kryetari i Grupit të Kuvendarëve të LDK-së, z. Arben Limani.**

**Arben Limani**, theksoi se kërkesa jonë për interpelancë ka të bëjë kryesisht lidhur me fillimin e vtitit të ri shkollor 2015/2016. “Pjetja tjetër ka qenë, pse në disa shkolla të komunës sonë që një kohë të gjatë nuk po zgjidhen drejtorët e këtyre institucioneve? A ka pasur pranime të kuadrit mësimdhënës pa konkurs publik në fillim të këtij viti shkollor? A është numri i kuadrit mësimdhënës të pranuar në konkurs publik në fillim të vtitit shkollor? Edhe kemi kërkuar nga DKA që të na ofrojë listën e kuadrit të pranuar që kanë konkurruar për t'u punësuar dhe listën e tyre që janë pranuar në punë. Këto kanë qenë kryesisht pyetjet të cilat i kemi adresuar DKA-së,” theksoi anëtarri Limani.

**Hajdin Morina**, theksoi se falënderoj GP për pyetjet e parashtruara, interesimin e tyre që kanë për zhvillimet në arsim në komunën tonë. Falënderoj gjithë grupet tjera parlamentare për interesimet që kanë pasur vazhdimisht për zhvillimet ne arsim. Me kohë i kam marrë pyetjet që i paraqiti Arbeni dhe jam munduar që brenda shënimive zyrtare të DKA-së dhe ndihmën e zyrtarëve të DKA-së të përgatitem për këto pyetje, që të bëj njëfarë raporti, një raport para jush. Fillimi i vtitit shkollor 2015/2016 ka filluar me kohë, më 1 shtator 2015 sipas kalendarit që bën MASHT-i, ajo i bën oraret kur fillon viti, kur mbaron semestri dhe kemi filluar pikërisht me kohë, brenda mundësive, resurseve njerëzore dhe brenda mundësive buxhetore që kemi pasur i kemi kryer të gjitha angazhimet ligjore që na kanë dalë për fillim të mbarë të vtitit të ri shkollor, me kohë i kemi siguruar librat, të cilat QK ka vite që i jep falas, mirëpo ne kemi marrë pjesë në menaxhimin teknik të tyre, pranimin e tyre, nënshkrimin e tyre. Po ashtu materiali pedagogjik ka ardhur me kohë dhe para datës 1 shtator çdo shkollë ka pasur tekstet shkollore, ato që pedagogjik ka ardhur me kohë dhe para datës 1 shtator çdo shkollë ka pasur tekstet shkollore, ato që kanë ardhur, por ka pasur që janë shtuar dhe kanë munguar ditët e para, dhe çdo shkollë ka pasur ditarët dhe gjerat tjera pedagogjike për të filluar viti i ri shkollor. Në komunën tonë e dini që funksionojnë 17 shkolla fillore amë, 2 shkolla fillore të mesme të larta dhe një çerdhe e fëmijëve. Si informacion po ju jap që me siguri ju nevojitet, sipas Programit SMIA, që është një program elektronik i MA, i përfunduar, i mbaruar me ndihmën e Bankës Botërore, SMIA (Sistemi i Menaxhimit për Informacione në Arsim), janë nxjerrë të dhënat e këtij fillim viti shkollor. Në shkollat tona punojnë gjithsej 659 personel krejt, punëtorë, mësimdhënës, administratë, ndihmës etj., prej tyre 34 për qind janë femra, mësimdhënëse janë 39 për qind, personel administratë janë 20 për qind, personel ndihmës janë 5 për qind femra. Po ashtu sipas të dhënavë ka filluar sistemi online, sivjet kemi 8751 nxënës në të gjitha nivelet, afér 300, përkatësisht 299 nxënës më pak se sa në vitin e kaluar. Afér 300 nxënës që do të thotë afërsisht sa shkolla e Jagodës dhe Budisalcit bashkë ose sa Budisalcit me Siqevën. Është një rënje e numrit të nxënësve që po na reflektohet pastaj në zbritje të normave të mësimdhënësve. Sivjet nuk na mbetet asnjë shkollë që nuk ka zbritje të normës për shkak të këtij zgogëlimi të nxënësve. Kurrikula vazhdon, është viti i dytë që Shkolla Teknike, Gjimnazi dhe shkolla “Azem Bejta” e Grabanicës që janë të përfshira në pilotimin e Kurrikulës së re të arsimit, pra në vitin e parë 2014-2015 kanë filluar klasa parafillore, klasa e parë e gjashtë edhe e dhjeta, kurse tashti në vitin e dytë janë shtuar këto që i përmenda. Tash prapë është klasa e parë me reformë kurrikulare me të renë, klasa e shtatë, klasa e njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë. Zyrtarët e drejtorisë dhe drejtoria vetë me ndihmën e drejtorëve janë duke e punuar një rregullore e cila do të vijë para jush, e cila e ndryshon, jo në përbajtje, jo në esencë por më shumë formën e Rregullores së vitit 2006 që ka miratuar AK, rregullore unike për sjellje të nxënësve në komunë. E kemi parashtruar në KPF të fundit, por nuk e di a ka kaluar të marr vizën e KPF-së, që asambleja t a votojë për debat publik, normalisht është draft një herë, por presim në atë drejtim. Qëllimi i ndryshimit jo në esencë për rregulloren në fjalë ka qenë e vitit 2006 na ndanë shumë nga ajo, se qëllimet dhe parimet e arsimit nuk ndryshojnë kurrë, s'kanë ndryshuar qindra vjet, por është qëllimi se

më 2006 nuk kemi pasur shumicën e ligjeve që sot mbulojnë fushën e arsimit. Atëherë nuk ka qenë Ligji Parauniversitar i 2011, atëherë nuk ka qenë Ligji për Arsimin në Komunat e RK të vitit 2008, që janë ligje bazike që mbulojnë këto fusha. Dhe prandaj jemi munduar kjo rregulllore të ndryshohet me dispozita dhe pjesë të këtyre ligjeve. Te pyetja e dytë, pse nëpër shkolla nuk po zgjidhen drejtorët, ne para datës gusht 2015, ka qenë vetëm një shkollë që nuk ka pasur drejtor, por ka pasur ushtrues detyre, është SHF “Tre Dëshmorët” në Jashanicë, kurse prej gushtit të këtij viti është një ushtrues detyre në Shkollën e Çabiqit, e cila është pavarësuar vitin e kaluar me vendim të Ministrit të Arsimit, sepse deri me atëherë ka qenë paralele e shkollës fillore “Ali Krasniqi” të Ujëmirit. Domethënë momentalisht kemi 2 ushtrues detyre. Pse ashtu? Për Jashanicë është përsëritur disa herë konkursi, mirëpo nuk kanë qenë tre kandidatë që duhet të jenë së paku tre kandidatë. Konkursi i fundit ka qenë i datës 20.1.015, diku ka fundi i shkurtit është shqyrtuar ai konkurs, sepse nuk bën të kalojë më shumë se sa një muaj pa u shpallur rezultatet e konkursit, nuk ka pasur fare kandidatë konkurrentë. Ka qenë konkursi që ka përfshirë për drejtorë shkolle Çabiqin, Jashanicën, Valljakun dhe Budisalcin, Në shkollën e Jashanicës ka vazhduar prapë dhe vazhdon ushtrues i detyrës Haxhi Avdyli, ekonomist, me shumicën e provimeve të kryera në Fakultetin Publik të UP, kurse diplomimin e ka bërë në Kolegjin Privat AAB, nga i cili edhe disa mësimdhënës. Arsyje tjetër të mosparaqitjes së kandidatëve ne kemi vlerësuar se është një trajnim që është me ligj të vitit 2011, kurse drejtorët që janë pranuar para atij viti nuk e kanë kusht atë. Është një trajnim për udhëheqje arsimore që duhet të kryhet, është i paraparë në ligj dhe nuk pranohen kandidatët që nuk kanë atë trajnim. Ne kemi arsimtarë që kanë atë trajnim, mirëpo nuk donë të konkurrojnë, janë pak ata që kanë kryer. Shumica e drejtorëve e kanë ata që janë. Ka drejtorë që nuk e kanë që janë pranuar para vitit 2011. Mungesa e këtij trajnimi po sjell problem në të gjitha komunat të RK. Kur ka qenë konkursi i fundit i shkurtit 2015 për përzgjedhjen e drejtorëve në Jashanicë, Çabiq dhe Bidisalc, anëtarë i Ministrisë ka qenë Fetah Kosumi i caktuar si anëtar nga Ministria, dy përfaqësues të Komunës dhe një nga Ministria, nuk ka pranuar që të bëhet drejtor dikush që nuk e ka udhëheqjen arsimore. Ne e kemi pyetur çka të bëjmë, Ministria ka thënë se Komuna ka ligjin për komuna dhe dispozitat tjera, ka mundësi tjera të bëjë ushtrues detyre. Ne nuk e nënshkruajmë thotë të bëhet drejtor shkolle nëse nuk e ka udhëheqjen arsimore. Kjo tash është problem, për arsy se duhet të ndryshohet ligji, në ligj paraparë, në ligj prej 2011 është e paraparë udhëheqja arsimore. Jemi duke bërë përpjekje që të trajnohen arsimtarët për udhëheqje arsimore, mirëpo nganjëherë nuk kemi pasur mundësi ta formojmë grupin, ministria po kërkon një grup së paku prej 15 vetë deri 20 etj. Ditëve të fundit e kemi formuar atë grup dhe kërkesën e kemi në ministri, mirëpo kur fillon ai trajnim varet prej Ministrisë. Pjetja tretë, a ka pasur pranime të kuadrit pa konkurs publik në fillim të vitit shkollor 2015-2016, e them se nuk ka pasur. Kurse për pyetjen e fundit, mendoj se keni listën prandaj konsideroj se edhe nuk kam shumë nevojë të flas. Mund t'i jap shifrat, numri i të pranuarve me konkurs publik është 29, kanë konkurruar 139, listën tash e dorëzoi te Arbeni. 139 janë konkurrentë, mirëpo duhet ta dini nuk janë të gjithë të profileve arsimore. Nga këta 139 ka profile joarsimore dhe domethënë nuk i kanë plotësuar kushtet. Me vonë konkurse publike nuk kemi pasur, janë pranuar sipas ligjeve, sipas udhëzimeve. Lista që po i dorëzoj Arbeni është listë e pranuar dhe e kërkuar edhe nga Sektori i Inspektoratit për Arsim në Pejë, që zakonisht në fillim të viteve kërkojnë raport të pranimit të atij kuadri, pastaj pasojnë ankesa, procedura tjera”, nënvizoi në ekspozenë e tij drejtori i DKA-së prof. Morina. Haxhi Ibishi, tha se unë vetëm kam një sqarim, jo çështje arsyetimi apo pafajësie por rregullorja që përmendet që ka ardhur është e vërtetë që ka ardhur në shërbim, ka ardhur me vonesë, karshi KPF-së dhe për atë arsy e kemi proceduar, sepse nuk ka asnjë arsy tjetër. “Kemi parë se kjo rregulllore mund të kalojë në procedura të rregullta dhe në nëntor do ta keni ne debat”, sqaroi Kryesuesi, i cili në vijim hapi diskutimin dhe kërkoi nga anëtarët që ta respektojnë rregulloren përkatëse. Tunë Dedaj, tha se falënderoj drejtorin për këto të dhëna që na i prezantoi, mirëpo kisha pasur dëshirë

që të gjithë këtë material të na i jep jo vetëm këtij që ka kërkuar, por të gjithë anëtarëve të KK. "Po ashtu kisha pasur një pyetje për t'ia bërë drejtorit, sa është i informuar drejtori që në procesin tonë arsimor shumë arsimtarë japid lëndë të tjera vetëm për t'ju ruajtur vendi i punës, si p.sh. arsimtarë i gjuhës shqipe jep kimi. Kjo na brengos neve si grup i AAK-së, për shembull në sh.f. "Ismet Raci", dy arsimtarë të gjuhës shqipe japid lëndë të tjera, nuk di çfarë lëndësh japid, vetëm për t'ju ruajtur vendi i punës. Kjo është e keqe, sepse nuk je duke i dhënë mësim atij, mirëpo je duke e lënë të hendikepuar në atë lëndë. Kështu ka në shumë shkolla jo vetëm në shkollën "I Raci", por edhe në "Motrat Qiriazi" etj. Edhe ju drejtor me siguri mund të jeni në dijeni, që është mirë për t'u formuar një grup më këqyr dhe të na informojë neve me shkresë se çfarë lënde japid, a janë në profesionet e tyre apo jo", theksoi anëtarë Dedaj.

**Arben Limani**, tha se unë e falënderoj profesorin për informacionin që na dha lidhur me shqetësimet tona. "Në fakt lista e pranimeve na erdhi tash dhe nuk kemi pasur mundësi ta shikojmë se kush ka ardhur edhe a kanë ardhur me kualifikime adekuate qysh është kërkuar në bazë të konkursit. Por, ne e dimë që këto dallime në shpallje të vendeve dhe moshpallje nëpër shkolla ka pasur. Edhe me qëllim kësaj herë nuk kemi dashur për t'i evidencuar, në mënyrë të mos personalizohen gjerat. Mirëpo, si shqetësim imi në një kontakt me disa të rindë që kanë edhe kualifikimet, ka qenë mospranimi i tyre ku kanë konkurruar dhe janë pranuar të komunave tjera. A është prioritet banori i komunës tonë para atyre të komunave tjera, kur edhe këta janë me kualifikime adekuate? Domethënë, unë i kam dy raste, nuk do ta potencoj asnjë rast me emër. Gjithashtu, një shqetësim që na ka ardhur nga disa prindër te klasa speciale në shkollën "I. Raci". Sa jam i informuar, aty ka tender për bartjen e nxënësve, është e rregulluar edhe me ligj, se ata nxënës duhet të barten me transport që duhet t'ju sigurohet nga Ministria e Arsimit, mirëpo kjo nuk po kryhet, ndoshta nuk kryhet si individualisht ndonjë nxënës, edhe këtë informacion ndoshta drejtori i Arsimit të na ofrojë. Edhe çështja tjetër që shqetëson në shkollën "Ismet Raci", a është ndërmarrë diçka për ato vjedhje që po ndodhin në këtë shkollë? Kam dëgjuar se kohëve të fundit ka ndodhje vjedhje, fotokopje, televizor dhe shumëçka tjetër. E di që më herët janë vjedhur i gjithë kompjuterët që na janë sjellë si donacion, por kohëve të fundit kam dëgjuar se janë vjedhur edhe pajisje tjera të konkretizimit", theksoi anëtarë Limani.

**Violeta Zefi**, tha se unë kam dy pyetje për drejtorin e Arsimit dhe disa komente po ashtu. Pyetja e parë është kjo: A keni ndonjë vendim nga Ministria e Arsimit për të hapur ndonjë vend pune për psikologë në shkolla, qoftë në shkolla fillore, apo të mesme të Komunës së Klinës. Nëse nuk keni vendim të tillë, atëherë a e konsideroni ju si drejtori të nevojshme që të hapni vend të ri pune për psikologë në shkolla. Psikologu do të mund të punonte edhe në dy vende, pra të lëvizte nga një shkollë në shkollën tjetër, aq sa do të ishte e mundur. Ju e dini që roli i psikologut në shkollë është jashtëzakonisht i rëndësishëm për nxënësit. Krejt kjo që të evitohen probleme si ngjarja e fundit, që besoj që të gjithë e dini (e keni dëgjuar në media), që ka ndodhur në mes fëmijëve të njërsës shkollë fillore këtu në qytet. Fjala është për dukurinë e shëmtuar të kërkimit të parave prej një grupei djemsh drejtuar një shoku të klasës. Kjo dhe shumë situata të tillë të shëmtuar do të mund të evitoheshin me praninë e një profesionisti, siç është psikologu në shkolla. Pyetja e dytë ka të bëjë me një shqetësim të drejtuar tek unë. Në Shkollën e Mesme Teknike, lëndën e Psikologjisë e jep një profesor që nuk e ka të përfunduar drejtimin adekuat. Pse po ndodh kjo? Ne e dimë se ka shumë vajza e djem nga Klinë që e kanë një kualifikim të tillë dhe do të mund të mbanin këtë lëndë (Psikologjinë), për të cilën janë të kualifikuar", ka pohuar anëtarja Zefi.

**Skënder Merturi**, tha se shqetësimet e mia lidhur me arsimin i kam adresuar dhe i adresoj në formë të pyetjeve. "A ka marrë ndonjë hap, apo a është në përgatitje në marrjen e ndonjë hapi për kontrolllet shëndetësore të nxënësve, sidomos të shkollës fillore, një. Dy: a ka menduar DKA për vendosjen e disa librave për t'i lënë nxënësit nëpër shkolla, kur dihet sidomos kur nxënësit I-IV bartin një çantë shumë të rëndë me vete ose të ketë të paktën një zgjidhje që një pjesë të librave t'i lënë në shkollë, ndërsa pjesën

tjetër që kanë të domosdoshme ta kenë me vete, në një farë mënyre po iu ndalet rrita edhe fëmijëve që kanë peshën shumë të rëndë të librave, domethënë nxënësit që e bartin me vete. E treta, është lidhur me maturantët: e di që maturantët e gjimnazit nuk kanë qenë të vendosur ose nuk kanë qenë të sistemuar në një vend të përshtatshëm, por kanë qenë në një hotel që nuk i ka plotësuar kushtet për vendosjen e tyre, bille ushqimi aty nuk ka qenë i mirë, derisa edhe fasule iu kanë ofruar për të ushqyer. Mendoj që nuk e kanë merituar nxënësit kur kanë paguar një shumë aq të madhe të parave dhe t'iu serohet ai ushqim, i cili besoj që nuk është i duhur, edhe nuk e kanë merituar. Edhe e katërtë është": a ka vendosur DKA cilat janë shkaqet e braktisjes së shkollës, cilat janë arsyet që fëmijët e lënë shkollën. Edhe një lidhur me pyetjen e maturantëve, me sa e di, ndoshta drejtori është më i sigurt, që Shkolla e Mesme Teknike nuk ka qenë në atë hotel ku ka qenë i vendosur gjimnazi", ka shtuar anëtarri Merturi.

**Fadil Gashi**, tha se ishte një raport i drejtorit, që po përmend trajnimin për udhëheqje për drejtorë, veç po dua për t'ju informuar se më 2013 me dëshmitarë të gjallë dhe prezent, e keni marrë pa trajnim drejtor në Grabanicë. Kisha për të pyetur, nëse është pilot-projekt, të na sqarohet te SHMT, sepse e kam parë orarin e nxënësve që në këtë shkollë teknike ka gjeografi, ka histori, ka mjekësi, ka psikologji, ka fizikë edhe kimi. Nëse është pilot-projekt po pajtohem i gjithë, është dashur të na sqarohet, nëse nuk është pilot-projekt dhe nuk është udhëzim prej Ministritë sikur për të gjitha shkollat tjera profesionale në nivel Republike, atëherë kjo nuk dallon prej shkollës tjetër, më nuk i mbetet emri as shkollë teknike, as profesionale, nëse kështu kombinohen lëndët. Dhe një çështje tjetër, duhet për të shkuar deri në oborr të shkollës së Këpuzit ku janë duke u kryer punimet, a ka mundësi kompania që po i kryen punimet të paktën ta lirojë një hapësirë të vogël nxënësve. Mua më ka rastisë puna të për të shkuar atje dhe e kam parë se ishte shumë ngushtë dhe se nxënësit nuk kishin mundësi as për të hyrë në këtë objektin e vjetër. Kompania e ka atë mundësi, nëse ju e kërkoni prej sa, për t'iu liruar një hapësirë nxënësve", nënvisozi anëtarri Gashi.

**Enver Gashi**, tha se kam dy pyetje për drejtorin e arsimit: "Megjithëse drejtori na njoftoi rrith trajnimit të udhëheqjes arsimore, po ashtu kemi pasur njoftim edhe nëpër shkolla rrith këtij trajnimi, e di që listat shkollat i kanë dorëzuar. Drejtori po që se ka mundësi për të na njoftuar sa arsimtarët e komunës sonë kanë shprehur interesim për këtë trajnim, a duhet të paguajnë arsimtarët dhe sa zgjat? - pyetja e parë. Dhe pyetja e dytë, disa shkolla në komunën tonë ende nuk kanë kabinete informatike, siç është shkolla e Volljakut e Përqevës etj. A ka mundësi të bëhet një zgjidhje sa më e shpejt rrith pajisjeve të kabineteve të informatikës të këtyre shkollave? - shfaqi interesimin anëtarri Gashi.

**Haxhi Ibishi**, kërkoi nga drejtori Morina që t'u përgjigjet shqetësimëve të anëtarëve. **Hajdin Morina**, tha se te pyetja e anëtarit Tunë Dëdaj, që dikush nga arsimtarë të gjuhës shqipe jep kimi, ne nuk kemi kurrrfarë informacione që në asnjë shkollë arsimtari i gjuhës shqipe jep kimi. Tek e mbrama zyrtarisht nuk jemi të njoftuar, nëse ndonjë drejtor nuk e ka dhënë informatën zyrtare mund ta verifikojmë atë dhe jemi kundër asaj. Nuk mund të na ndodh kjo që lënda shoqërore të na kombinohen me lëndën natyrore. Në shkollat e vogla ndodh që një orë muzike, arti figurativ ta mbajë një arsimtar i artit ose një profesor ndoshta edhe i gjuhës shqipe, për shkak se punën 20-30 vjet dhe për t'mos iu zbritur norma, mundet, mirëpo janë raste të rralla. Rrith drejtorit të Grabanicës do ta vërtetoj, do ta pyes rrith këtij procesi, te Arbeni rrith pranimit të kuadrit, komuna jonë me komunat tjera, normalisht jemi munduar që në çdo shkollë kur ka pasur kandidatë të diplomuar të komunës së Klinës ta marrim të Komunës së Klinës, por aty kur ka qenë i komunës tjetër, që është dashur patjetër për të marrë të komunës tjetër, sepse nuk kemi pasur ne kuadër. Na është dashur të marrim të komunave të tjera në gjimnaz për lëndën e matematikës, profesor të matematikës, nuk i kemi marrë dy që kanë kryer drejtime tjera jo arsimore të matematikës, të kompjuterikes, jo me matematikën arsimore qysh shkruan UA dhe një kemi marrë nga Istogu për matematikë, i diplomuar, s'kemi pasur tonin dhe një nga Skenderaj për frëngjisht për arsyet se s'kemi pasur tonin. Këto dy raste i di, rastet tjera nuk i di. Mirëpo, sa jam

konsultuar me drejtorë dhe komision. Transporti i fëmijëve me nevoja të veçanta, është e vërtetë që komuna obligohet që këtyre fëmijëve t'u sigurojë transportin. Mirëpo në Klinë, periferi të qyteteve nuk u paguhen për arsy se edhe prindi e ka do obligim edhe me ligj të arsimit parauniversitar, prindi dhe ministria dhe komuna obligohen që t'i shkollojnë fëmijët. Mirëpo këta me nevoja të veçanta janë diçka tjeter, kurse për çdo rast tjeter të shkollimit të fëmijëve me nevoja të veçanta, në qendrat tjera ku iu ofrohet shërbimi ne bëjmë transportin e tyre falas. Janë disa raste që shkollohen në Prizren, Pejë, dhe ne i kryejmë ato transporte, kurse për në qytet ne nuk paguajmë. Dëmtimet, vjedhjet, në shkollën "Ismet Raci" kanë ndodhur disa herë, ka pasur vjedhje me pasoja materiale kur janë vjedhur disa kompjuterë, dihet para 2-3 vitesh. Disa herë aty ka pasur vjedhje dhe thyerje, herën e fundit janë vjedhur materiale mësimore na ka njofuar drejtori se është thyer dera e tij, po ashtu një derë tjeter është thyer, ka pasur shkaravatinë materialeve, të dokumenteve, mirëpo diçka e vlefshme nuk është vjedhur. Drejtori i shkollës Policinë e ka lajmëruar për çdo rast tjeter dhe policia e heton më mirë ato raste. Sa i përket pyetjes së anëtarës Violeta Zefi, është e vërtetë që shkolla nuk bën të merret me mend pa psikologë dhe pa pedagogë, rëndësia e tyre dihet, sidomos sot kur fëmijët kanë plot rrugë tjera dhe ne do të jemi kundër atyre rrugëve. Është e vërtetë që MASHT në udhëzimin nr. 30/2014 ka miratuar pranimin e psikologut dhe të pedagogut. Mirëpo MASHT nuk na ka ndihmuar si duhet në këtë drejtim, që para disa viteve ka siguruar, na ka lejuar për ta planifikuar dhe lejuar për të kaluar buxhetin për një pedagog, kurse tash nuk na i lejon ato dhe nuk na lejon planifikimin. Sepse psikologu dhe pedagogu, mjeku parashihen mirë dhe të shkruara janë me këtë udhëzim, mirëpo ne nuk po kemi mijete financiare për ta. Në SHMP se jep një sociolog me duket, aty janë pak orë psikologjie që ka marrë diku 10 orë, s'besoj se janë 10 orë. Pyetjeve të anëtarit Skënder Merturi, kontrollet shëndetësore të nxënësve janë bërë disa vizita. Është mirë të bëhen kontrollime shëndetësore, do të bëhen kontrollime shëndetësore edhe në disa vizita. Është mirë të bëhen kontrollime shëndetësore, do të bëhen kontrollime shëndetësore edhe në të ardhme. Për peshën e çantës së fëmijëve, pyetje me vend, drejtorë të shkollave janë shumë të pavarur ta zgjidhin këtë problem, më ndihmën e kujdestarëve të klasave, të mësuesve, ata e dinë a mund të bëhen këto zgjidhje sepse janë disa lëndë që vazhdimisht kërkojnë angazhime sistematike, si gjuha shqipe, matematika etj., mirëpo mund të bëhet një zgjidhje. Megjithatë mund të ndodh që çanta të lehtësohet pak, ne do të insistojmë që të ndodhë ajo në takimet me drejtorë që i kemi. Sa i përket shkuarjes së nxënësve në ekskursion dhe kalimit të tyre, është përgjegjësi e drejtorisë së shkollës, përgjegjësi e prindërve që kanë nënshkruar të shkojnë fëmijët e tyre atje. Unë nuk kam informatë zyrtare që kanë kaluar keq. Kështu që në bazë të ligjit ne nuk kemi të drejtë të ndërhyrë në çështjet që janë në kompetencë të tjeter kujt, sepse nuk është çështje që menaxhojmë ne. Shkaqet e braktisjes është çështje që shketëson edhe komunën tonë edhe komunitat tjera, nuk kemi numër braktisësh në rritje vazhdimisht sillet 80-90 në vit, janë shkaqe ekonomike, ndoshta edhe jo ekonomike që shkaktojnë braktisjen. Kemi një braktisje të madhe që nxënësve të komunitetit rom dhe shkali, që mundohemi t'u ofrojmë edhe atyre ndihmë se janë shkaqet materiale në transport, nganjëherë duke bërë edhe diskriminim pozitiv, por bëhet për shkak vetëm se ata të mos e braktisin shkollën, dhe ne ju ndihmojmë që brenda kilometrave të lejuara për mos transport t'i transportojmë, mirëpo qëllimi ynë është që ta zvogëlojmë braktisjen. Në Grabanicë e di që ka kryer udhëheqje mësimore, megjithatë dokumenti është pajtohem me atë që është e vërtetë. E vërteta është se është i paraparë me ligj ai trajnim. Për shkollën profesionale për lëndët që ndërrohen aty, është e vërtetë ajo që përfshitet Fadil, është pilot-projekt dhe ato luhatje që ke shkaktojnë kurrikula me zgjedhje ose lëndë zgjedhore. Shkolla është e pavarur deri afér 20 për qind që mësimin zgjedhor ta organizojë vetë. (Drejtori sqaroi këtë organizim të këtij sistemi kurrikular). Për Këpuz, janë duke u zhvilluar punimet për ndërtimin e objektit të ri shkollor, rreth hapësirës do të angazhohem edhe me ndihmën e Urbanizmit dhe do të kërkojmë që fëmijët të kenë hapësira të nevojshme. Ishte një pyetje rreth trajnimin e udhëheqësve arsimorë, tha se deri vonë nuk kemi mundur ta bëjmë një listë për të

organizuar trajnimin e udhëheqjes se na është kërkuar nga Ministria, kurse tash kur është shpallur se nuk po zgjidhen drejtorët pa trajnim ka interesim më të madh. Ministrisë i kemi bërë kërkesë që trajnimi të bëhet pa të holla, mirëpo tash të shohim derisa të miratohet. Jemi që të sigurojmë kabinete të TIK-ut edhe vë Volljak edhe në Çabiq, sepse kabinetin i TIK-ut nuk e ka rëndësinë vetëm për TIK, pro ka rëndësinë e mbajtjes së çdo ore mësimore. (Sqaroi edhe disa çështje rreth çështjes bosht, përkatësisht rreth organizmit të mësimit elektronik). Bëra përpjekje të jem objektiv, të them ato që i di, tekefundit cilidu nga ju keni mundësi për çdo çështje që lidhet me arsimin të keni qasje zyrtare në dokumentet zyrtare etj”, shtoi drejtori Morina.

**Tunë Dedaj**, tha se nuk kam asgjë personale me drejtorin, por le të jetë shumë i bindur se unë i garantoj që dy arsimtarë të gjuhës shqipe i ka tepër në shkollën “I. Raci”, të cilët janë lëndë tjera jo gjuhën shqipe. “Le të informohet, po që se nuk është kështu, atëherë unë jam në gjendje t'i kërkoj falje. Por ashtu qëndron dhe kërkoj nga drejtori t'i shikojë mundësitë të hulumtojë dhe ne nuk kemi nevojë që dikush me gjuhë shqipe të jap as art, as muzikë nëse ka të tjerë të diplomuar dhe që presin punë”, tha ai. **Arben Limani**, tha se desha për ta pyetur drejtorin e Arsimit, sa është e rregulluar me ligj, përkatësisht me Udhëzimin administrativ që shkollat të udhëhiqen me ushtrues detyre. “Edhe atë që tha drejtori për ato dy rastet për i përmenda të komunave tjera, unë pajtohem kur konkuron tjetri edhe i komunës tjetër me përgatitje më të lartë të merret ai, mirëpo të dy të diplomuarit, DKA i ka mundësitë, sidomos në gjimnaz ku kanë konkurruar, t'i sistemojë nëpër shkolla tjera ku nuk janë të kualifikuar. Këtë mundësi e ka DKA edhe pse nuk konkuron në shkollën e caktuar. Ne kemi raste kur punojnë me nga 20 vjet studentë të përjetshëm dhe vazhdimesh mbesin po ata”, pohoi anëtari Limani.

**Ndue Shabanaj**, theksoi se propozimi im është konkret që të bëhet praktikë që çdo vit në Kuvend të raportohet për përgatitjet për fillimin e viti shkollor në kohën e paraparë. “Është diçka me interes jo vetëm për DKA-në, por për të gjithë qytetarët dhe njerëzit që kanë fëmijët e tyre në shkolla, por edhe për ata që nuk i kanë. Prandaj, preokupimi ynë në këtë drejtim është mirë për t'u realizuar dhe për të qenë i rregullt i raportimit para çdo fillimi të vitit shkollor për përgatitjet që janë bërë për fillimin e viti shkollor. Çështje tjetër është, unë mendoj që tanë jemi në momentin kur është dashur të shqyrtohet edhe më tepër të angazhohemi për sigurimin e ngrohjeve nëpër shkolla. Sa unë kam informacion ka dilema për të siguruar ngrohje nëpër shkolla dhe ne e dimë që po i afrohemë periudhës së ftohtë dhe pamundësisë së zhvillimit të procesit mësimor për shkak të mungesës së ngrohjes. Unë po flas për shkollën ku punoj, gjimnazin “Luigj Gurakuqi”, shumica e dimë në çfarë gjendje është ngrohtorja. Dhe kërkesa ime është angazhimi që të mos cenohet procesit edukativo-mësimor, përkatësisht të mos humben ditët e mësimit. Çështje tjetër është angazhimi i punëtorëve në vendet vakante dhe që paraprakisht ka pasur punëtorë në vendet e caktuara, kurse largimi i tyre për shkak të pensionimit ose pranimi ne institucionë të reja është bërë një praktikë e dëmshme shumë angazhimi i punëtorëve para se të hapet konkursi. Kjo po i paraprinë pranimit të tij edhe pas hapjes së konkursit. Prandaj, aty ku hapet vendi i ri i punës, aty duhet të hapet konkursi, aty cuhet të pranohet punëtori sipas konkursit dhe kritereve që i parashevë konkursi. Se po krijon një pabarazi të qytetarëve dhe po i kushton edhe drejtorisë, na kushton edhe ne të gjithëve. Dhe më ne fund unë them se çështja e institucionit të konkursit ishte dashur të merret parasysh gjithmonë se ka ekzistuar më herët, është dashur edhe tash të ekzistojë, në konkursin i rregullt, në konkursi plotësues dhe konkursin e jashtëzakonshëm. Aty ku kuadri mësimor kërkohet për profilin përkatëse por nuk ka konkurrent ishte dashur edhe konkursi i jashtëzakonshëm për shkak të specifikave që ka secili vend i punës dhe secila lëndë mësimore. Një çështje tjetër, këtu u përmend trajnimi, Korniza kurrikulare e Kosovës, megjithatë kjo pjesa tjetër që u tha, trajnimi për udhëheqje arsimore, është çështje se kur bëhet kusht për t'u zgjedhur drejtor i një shkolle ky lloj trajnimi, atëherë është problem se si për t'u menaxhuar kërkësën e njerëzve për t'u përfshirë në trajnim. Nëse deri tash nuk ka pasur të interesuar tash ka sipër interesim për këtë punë. Dhe

ky interesim i tepërt i punëtorëve të arsimit nuk duhet të lejohet krejt në baza spontane ose të përcaktimit të DKA-së, se po ka anshmëri edhe këtu, dhe ishte dashur të krijohen kriterë të përfshirjes, qoftë sipas numrit të përgjithshëm të punëtorëve të arsimit nëpër shkolla, ose sipas shkollave të ndryshme, e jo të caktohen në një formë tjetër sipas farë simpatie apo antipatie. Nëse ajo është një domosdoshmëri për të marrë pjesë në konkurs dhe për t'u zgjedhë, atëherë duhet për të qenë mënyra përcjelljes në kalimin e këtyre trajnimeve të përcaktuara sipas kriterieve”, ka konstatuar profesor Shabanaj.

**Halil Desku**, tha se e dëgjuam me vëmendje fjalën e drejtorit të Arsimit, ka qenë një raport shumë përbajtjesor. “Unë do të qasem rrëth këtyre çështjeve sepse jam pjesë e këtyre zhvillimeve në arsim. U përmend për ndërrimin e lëndëve, se kam obligim këshilltarëve t’ju jap përgjigje, atë e ka drejtori i Arsimit, mirëpo qëllimi i angazhimit tim është për t’i kontribuar debatit dhe askush të mos preket, por angazhimi im është të prezantojë disa çështje ashtu qysh e njoh situatën. Ndërrimin e lëndëve e potencoi dikush. Është mirë të informohemi drejt dhe të qasemi me seriozitetin më të mirë, kur dëgjojmë diçka që po ndodh. Është normale për të dëgjuar se ne kemi fëmijë, përmes fëmijëve ne marrim gjithçka. Ndërrimi i lëndëve kurrë s’ka ndodhur as nuk mund të ndodh, por ndodh vetëm me ligj. Tash jemi dëshmitarë të ndërrimeve në sistemin e arsimit. Tash jemi duke zbatuar një punim kurrikular dhe janë dhjetëra shkolla në Kosovë që janë në programin pilot-shkolla. Te ne janë 3 pilot-shkolla, një prej këtyre shkollave është edhe gjimnazi. Në atë pilot-shkollë jam gjenerata e parë që jam trajnuar, dhe jam koordinator i shkollës dhe përcjelli këtë sistem të shkollimit deri sa të përfundoj. Pastaj pritet që në këtë sistem shkollor të përfshihen të gjitha shkollat. Ky sistem i shkollimit është bashkëkohor, i ri për ne, dhe është problem për ta kuptuar edhe në vetë që merremi dhe punojmë me te. Ka disa gjera dhe disa risi që kurrë nuk kanë ndodhur në arsim. Nuk ka lëndë, por ka fusha lëndore, dhe shkolla ka autonominë e vet, e ka autonominë e vet fusha kurrikulare. (Profesor Desku në vazhdim i potencoi dhe sqaroi çështjen e fushave kurrikulare, ku sipas tij janë 7 fusha dhe mësimi me zgjedhje, që do të thotë 8 fusha). Kam për obligim për t’u përgjigjur edhe në një pyetje rrëth organizmit të ekskursionit, kamë qenë pjesë e atij organizimi, mirëpo të fliten fjalë që nuk kanë qenë lëndohemi edhe ne. Përgjigen e ka dhënë edhe drejtori i Arsimit. Nuk do të flas për SHTP, por për gjimnazin. Asnjëherë në gjitha përvojat e mia nuk ka pasur ndonjë mos organizim i nivelit dhe janë realizuar suksesshëm. Edhe kësaj radhe unë s’kam qenë por kam informacione edhe nga drejtori dje gjithë mësimdhënësve se ka qenë një ekskursion i mrekullueshëm, ku nxënësit i kanë kryer obligimet konform rregullave shkollore, e kanë realizuar qëllimin, kanë qenë në një hotel shumë të mirë, me gjitha masat e sigurisë së nxënësve dhe personelit arsimor dhe ajo na bën nder edhe neve, sepse ne më së pari mendojmë për sigurinë e tyre, të udhëtimit, të qëndrimit atje dhe pastaj vjen ushqimi. Edhe ushqimi ka qenë i lëvdueshëm, shtoi profesor Desku.

**Qamile Qitaku**, tha se falënderoj drejtorin e Arsimit për informatat që na i ofroi, do të ndalesha te braktisja e nxënësve, me sa kam kuptuar, numri i të braktisurve në vit është 80-90. “Shkaqet na i numëroi drejtori se janë të ndryshme, mirëpo me sa kuptova unë një numër i madh është edhe për shkaqe të varfërisë. Prandaj, e di që është shqetësuese, pyes drejtorin, a ka mundësi të krijohen fonde të ndihmohet këtyre nxënësve që të vazhdojnë shkollën. Me theks të veçantë e kam fjalën për këtë kategorinë që nuk vijojnë mësimet për shkaqe të varfërisë”, shtoi anëtarja Qitaku.

**Petrit Palushi**, tha se desha të lidhem me pyetjen e ekskursionit, i drejtohem drejtorit të Arsimit, a kishte pasur mundësi për të pasur një bashkëpunim me drejtorin e shkollës së mesme që në ekskursion të shkojnë vetëm ata nxënës që janë me notë mesatare më të lartë në mënyrë që viteve të ardhshme t’i stimulojmë nxënësit tjerë që të mësojnë pak më shumë.

**Haxhi Ibishi**, tha se kjo është interpelancë nuk merret ndonjë vendim. “Edhe unë shprehi një falënderim karshi ekzekutivit i cili kësaj AK t’i përgjigjet për të gjitha çështjet që ngrit që dy vite. Unë jam i vetëdijshëm që kemi përmirësime, por në qoftë se brenda një viti kalendarik kjo asamble debaton dy probleme të arsimit, përkatësisht dy kërkesa të opozitës për interpelancë me drejtorin e Arsimit, mendoj

që është edhe një gatishmëri e ekzekutivit që të jetë sa më transparent”, pohoi kryesuesi Ibishi. **Hajdin Morina**, tha se rreth trajnimeve ne kemi bërë një përzgjedhje të mirë, kemi pasur kritere, është dashur që arsimtarët të keni më shumë se 3 vjet përvojë pune, të ketë përgatitje profesionale, katërvjeçare, jo trevjeçare, qysh parashihet edhe me ligj për drejtor. Dhe nuk kemi shkuar listat e trajnimeve me kurrfarë simpatie, kemi refuzuar disa që akne ardhur mbas afati. Rreth pyetjes se anëtares Qitaku rreth ndonjë fondi për nxënës të varfér, nuk kemi subvencione, por kemi forma për t’ju ndihmuar atyre, sepse është arsimi për të rritur i licencuar, për shkollën 9-vjeçare për ta kryer të rriturit, ata që braktisin për shkaqe të ndryshme, është e licencuar “I. Raci” dhe pa pagesë bëhet, ndërsa profesionale është “Fehmi Agani”, domethënë ka mundësi që ata arrijnë shkollimin, mirëpo me të holla nuk kemi fonde. Rreth pyetjes së anëtarit Palushi, me UA parashihet ekskursioni i nxënësve të bëhet në shtator ose në maj të viteve kalendarik, mirëpo a mund të bëhet ky reduktim, edhe me ligje është që, përkatësisht një nga format e ndëshkimit në ligj për nxënës të shkollës së mesme të lartë, kurse për fillore kemi shumë të kufizuar ndërmarrjen e masave, sepse është mësim obligativ, është që nxënësit të mos shkojnë në ekskursion, gjegjësisht të përjashtohet nga ekskursioni, është një nga masat. Drejtorët e shkollave kanë të drejtë për të marrë këtë masë, d.m.th. nxënës që kanë bërë probleme, një nga masat disiplinore është përjashtimi i mospjesëmarrjes në gara, ekskursione etj., këto mund të bëhen”, sqaroi drejtori Morina.

#### Pika e shtatë: Shqyrtimi i rekomandimeve të KPF-së, dt. 19.10.2015.

**Haxhi Ibishi**, tha se të gjitha këto tema që sot i debatuam i kemi pasur edhe në KPF, kemi dy çështje që kanë ka rekomanduar KPF për AK. “Është një kërkesë publike për institucionet komunale dhe ato qendrore, lart shkruan si kërkesë publike, nuk shkruan peticion, por më vonë është si nismë apo peticion për parandalimin e ndërtimeve të shtëpive dhe të objekteve të larta në zonën rurale bujqësore, ZK në Dresnik. Secili prej jush e ka një kopje të parashtresës së kësaj nisme nga qytetarët për një debat në AK dhe në instancat tjera. Prandaj ne në KPF kemi debatuar, të gjithë kemi qenë unikë që kjo çështje të vije për debat në AK. Të gjitha pushtetet qofshin këto aktuale, qofshin ato që do të vijnë, qofshin ato të kaluara, e kanë kontinuitetin e veprimit, edhe gjithmonë kontinuiteti i veprimit, i vendimeve që merren qoftë në AK, qoftë në ekzekutiv, janë vendime legjitime që duhet të respektohen në vijimësi derisa nuk ka vendim të ri. KPF ka kërkuar nga drejtorët gjegjëse të bëhet një debat në këtë seancë për kërkesat që kanë parashtruar qytetarët e komunës sonë, gjegjësisht një pjesë e qytetarëve të komunës sonë, janë diku 81 nënshkrues”, tha kryesuesi Ibishi.

**Zeqir Morina (drejtor i Gjeodezisë)**, tha se unë e kam parë dhe e kemi në materialet tona një nismë siç thotë kryesuesi, gjegjësisht një peticion prej fshatarëve, rreth çështjes së asaj prone bujqësore, që është rezervat bujqësor, që quhet “Dresnik”. “ Në peticion e pashë të shkruar se pushteti ka stimuluar. Dua t’ju them këtu juve se ligji nuk e ndalon parcializimin e pronave private, sepse aty në petacione thuhet se ne e kemi stimuluar duke i parcializuar, duke i ndarë pronat, duke i shitur etj., por ligji nuk e ndalon parcializimin, do të thotë se parcializimi është çështje private, a do ta shes, a do ta ndajë apo mos ta ndajë. Prandaj, ne si DGJ ata që kanë bërë peticionin nuk kanë mundur të kuptojnë se DGJ nuk e ka këtë kompetencë , por ashtu kanë menduar dhe ashtu na janë drejtuar neve. Sa për sqarim, mund të shtoj se para disa viteve ka qenë një vendim nga AK që kanë qenë të ndërtuara 9 shtëpi dhe janë pezulluar ato 9 shtëpi me qëllim që të ndalohet ndërtimi i mëtutjeshëm, mirëpo kur unë kam ardhur më 2008 drejtor i Urbanizmit i kanë gjetur 80 shtëpi të ndërtuara në atë pjesë, prandaj ka vazhduar ai trend i ndërtimeve në mënyrë të egër, pa leje, ndoshta edhe janë dyfishuar, por është kjo gjendje që është”, theksoi drejtori Morina.

**Ndue Shabanaj**, theksoi se me kujtohet fort mirë si anëtar i AK ka qenë një vendim i veçantë të AK ajo pjesë është shpallur rezervat bujqësor. Dhe vendimi që është marrë nga AK është dashur të respektohet,

të zbatohet nga ekzekutivi pavarësisht e kujt ka qenë dhe e kujt është shumica, e udhëheqjes në pushtetin lokal të Komunës së Klinës. Vendimet janë obligative të zbatohen. Ky petition i këtyre banorëve është si një vërejtje publike ndaj moszbatimit të vendimeve tona. Dhe mendoj se atëherë kur kemi marrë vendimin kanë qenë vërtet 9 shtëpi, nuk jam i sigurt 9 apo 11, por e kam përshtypjen se mos të ishte marrë vendimi për t'u shpallur rezervat bujqësor ndoshta procesi i ndërtimëve në atë zonë do të kishte shkuar më ngadalë, së paku po më qet për të dyshuar kjo punë. Vetë marrja e vendimit për t'u shpallur rezervat bujqësor ajo pjesë, sikur ka stimuluar ndërtimin në të njëjtën zonë. Njerëzit i kanë pronat në atë pjesë, mirëpo ndërtimet që janë bërë pas këtij vendimi, i dimë edhe investimet që i kanë bërë qytetarët. Këto investime natyrisht se ne duhet pér t'i pasur parasysh të gjithë, por duhet ta kemi parasysh edhe neglizhencën e pushtetit lokal pér zbatim të vendimit. Është diçka që na bën të shqetësohem si asamble dhe pushtet lokal. Nëse deri tash nuk është respektuar kjo dhe ka ardhur deri këtu gjendja, atëherë përgjegjësia nuk i hiqet asnjë pushteti të hallkave të ndryshme të pushteteve qysh janë ndërruar prej atëherë e deri tash, përgjegjësia mbetet në institucionet e pushtetit lokal në Klinë, por së paku kishim dashur që tani e tutje të ndërpitet çdo formë e ndërtimit aty. Dhe me çështjet e moszbatimit të vendimit janë procedurat tjera, mos t'i lidhim këto, ka shkuar deri tash dhe le të vazhdojë edhe më tutje”, pohoi prof. Shabanaj.

**Tunë Dedaj**, tha se mendimi im dhe i grüpuit tim është që të respektohet vendimi i komunës që ka qenë pér rezervat bujqësor, të mos lejohet asnjë shtëpi pér t'u ndërtuar, e jo të lejohet të ndërtohen shtëpitë pastaj pér t'ju prishur, sepse është mëkat që një familje ndoshta buxhetin e gjithë jetës së tij e investon në shtëpi edhe ne si komunë e lëmë pér të ndërtuar pastaj të vije çështja deri te rrënimi. “Të merren masa qysh në themel, ka inspektorë të ndërtimit dhe qysh në themel të shkojnë dhe t'ua ndërprenë punët”, tha anëtari Dedaj.

**Skënder Merturi**, tha se këtë kërkësë e shoh si thirrje që e kanë bërë banorët e asaj ane pér të marrë ne vendime. “Faktikisht nuk po zbatohen vendimet që i ka marrë kjo asamble, pa marrë parasysh prej kujt është qeveria. E kam përsëritur disa herë, ndërtimet në atë zonë, ndërtimet në Komunën e Klinës, kaq të hovshme, kaq të mëdha kanë filluar qysh herët, pothuaj qysh pas luftës. Prandaj fajtorë kanë qenë gjitha qeveritë që kanë qenë paslufte në Klinë, se prej asaj kohe ka filluar, nuk ka filluar më herët. Thirrjen e këtyre unë e shoh si “a ;po zbatoni ligjin ju, apo po e zbatojmë ne si qytetarë? Derisa ne i kemi nxjerrë disa rregullore, i kemi nxjerre disa vendime, atëherë qeverisja lokale po tregohet e pafuqishme pér zbatimin e vendimeve që i ka nxjerrë. Kjo i bien, ose zbatojini këto vendime që i keni nxjerrë ose dilni, ka kush pér të ardhur që zbaton vendimet këtu. Nuk shkohet në këtë mënyrë, e kanë nisë ata mbrapshtë, po e vazhdojmë edhe ne mbrapshtë. Nuk ka logjikë, e mbrapshta është e mbrapshtë. Nëse e ka nisë dikush mbrapshtë më herët duhet të dal dikush pér të vënë në rregull. Nëse kjo qeverisje që është sot e PDK-së vazhdon mbrapshtë, atëherë dilni se ka kush e qet në terezi këtë farë vendi. Ka kush se i merr vendimet, ka kush që i zbaton vendimet. Shembulli më i mirë pér këto ndërtimet pa leje e pér ndërtimë e pér urbanizëm është Komuna e Prishtinës ku po punohet në vazhdimësi po ju kallëzohet, po ju jepet rrugë. Unë këtë mënyrë e shoh se qytetarëve iu ka ardhur shpirti te hunda, siç thotë populli, edhe kanë drejtuar këtë petition. Unë bëj thirrje që vendimet që janë marrë pér mosndërtim të vazhdon Drejtoria e Inspektoratit, Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Urbanizmit, gjitha drejtoritë, të zbatohet ai vendim, se është e kundërligjshme dhe kur është e kundërligjshme, pse ne pér të mos e zbatuar ligjin. Nuk është personale pér askënd. Ligji është pér të gjithë dhe pér të gjithë duhet pér t'u zbatuar. Nuk ka shkelje të ligjt pér hatër të dikujt të një daje apo kushërin. Ligji vlen pér të gjithë, pér të gjithë duhet zbatuar. Unë të paktën këtë mënyrë e shoh kështu, është thirrje që na janë drejtuar qytetarët të asaj pjese neve, aman zbatojeni ligjin se donë të na mbysin me ndërtimë”, theksoi anëtari Merturi.

**Fadil Gashi**, theksoi se tash po flitet pér një vendim të 2006 dhe po filloj me këtë vendim. “Është mirë që vendimet të lexohen prej fillimit deri në fund, kjo është me rëndësi. Sepse në pikën e parë kemi folur

për 9 shtëpi të ndërtuara. Dhe është mirë për të lexuar edhe pjesën e fundit që i është bashkëngjitur po këtij vendimi pra të të njëjtën seancë të asaj kohe, ku nga vërejtjet dhe sugjerimet të anëtarëve të Kuvendit, të atij mandati, pras dalin sugjerimet dhe miratohen ato sugjerime, besoj se të gjithë e keni këtë material, edhe në faqen e fundit të këtij reporti që del i rekomandohet kompanisë e cila është kontraktuar prej Komunës që ka kontraktuar PZHK me Urban +, se një ndër tjera, s'po i cek të gjitha me radhë, por në atë të parafundit ku thotë: "Zona e ndërtimit të zgjerohet edhe në zonën "rezervat bujqësor". Do të thotë është diçka që ka dalë si sugjerim i atyre anëtarëve të KK, që kanë marrë po të njëjtin vendim. Tash deri ku kanë shkuar procedurat të shikohen mundësitet, ne jemi dëshmitarë që është tejkaluar jashtë, ekstremisht jashtë atij numrit prej 9 shtëpive, edhe tash jemi para dilemave për këtë zonë, se çfarë tash duhet bërë? Numri është jashtëzakonisht i madh, edhe pushteti në këtë rast, edhe i ekzekutivit sidomos janë në kushte jo të mira në këtë rast janë në kushte jo të mira qoftë për tëe ndërmarrë vendim përrënim, që do të kishte qenë akti i dhimbshëm, po e quaj i dhimbshëm, ose ti duhet respektuar se edhe diçka të mos interpretohet që Komuna e ka ndaluar atë zonë. Është diçka që ka ardhur prej nivelit qendror, Komuna vetëm e ka respektuar, si zonë e shpallur me këtë kulturë bujqësore dhe veç e ka vazduhar këtë pjesë. Nuk është diçka që ka lindur prej Komunës. Edhe sot e ke po të njëjtën kulturë, derisa të bëhet ndryshimi. Për t'u bërë ky ndryshim nuk e kemi ne këtë mandat e ka qendror që ne nuk mund të marrim ndonjë vendim tjetër. Po lëshohem pak te peticioni, mendoj si të doni, mirëpo te unë ka dilema rrëth këtij peticioni, edhe te origjinaliteti, edhe pse unë nuk dua ta quaj "teknik" sepse këtu thotë muaj dhjetor 2014, nëse është gabim viti, bile muaj ndoshta kishte pasur mundësi për t'i përshtatur. Për mua diçka nuk është e qartë, nëse ne kemi ardhur në gjendje që qytetarët me peticion të na thonë "respektojeni ligjin", shikon, qytetarët e bëjnë peticionin kur kuveni merr një vendim që bien ndesh me interesin e tyre. Kjo është arsyaja e peticionit. Te teksti i peticionit, sikur do për të amnistuar një sektor dhe për të akuzuar një sektor tjetër, kush kujt po ia lëshon në këtë rast. Shikoni, drejtori të Komunës janë 10 dhe kujtoj që janë të barabarta, edhe karshi kompetencave, por edhe ndaj obligimeve që kanë ndaj qytetarëve. Nuk është e sinqertë që krejt problemin duhet bërë pa paragjykim se çdo drejtori e ka këtë përgjegjësi, tash të kalohet në DGJ. Nuk dua t'i dal në mbrojtje një drejtorie, ekzekutivi është një, është punë e përbashkët. Mënyra më e pandershme dhe e papërgjegjshme e drejtorëve është kur ju drejtohen qytetarëve dhe qytetarët vijnë te unë dhe më drejtohen "lëre Komunën të na jap leje!" Është veprimi më i ulët dhe i lig t'u thuhet qytetarëve që Fadili me LDK-në flasin, se ne "ju japim lejet!" Me ardhur qytetarët e të më thonë, "pse ju LDK-ja s'po më leni për të marrë lejen? Kjo është e pasinqertë, është jo njerëzore dhe ata që ju kanë thënë është mirë për të dalë këtu. Nuk lihet me këso kute. Është shumë e vërtetë se kam folur shumë për ndërtimet e larta, por kurrë me emër nuk jam marrë. Kam akuzuar Komunën por jo individët, jo njerëzit a ndërton në tokë private apo ku ndërton. Nuk ka qenë në natyrën time një herë në këtë seancë t'i marr në gojë njerëzit, as LDK-ja. Ne flasim në parim këtu. Dhe nëse dikush tenton për t'i tjetësuar qytetarët, kjo është e ligë dhe unë po bëj thirrje, ndërprenjeni se nuk është praktikë e mirë. Dhe ne nuk kemi në dorë, as nuk mund t'ju japim lejet, as t'ju marrim. Edhe publikisht po e them, edhe publikisht e sqaroj edhe atë qytetari, Sheremet Dushi, se nuk është në dorë të opozitës të cilil i është thënë, pra nuk është në dorë as të Fadilit, as të LDK-së. Por nuk është në dorë as të pushtetit sepse nuk keni të drejtë për të lëshuar leje ju. Unë edhe po ju mbroj juve edhe po më leni keq me qytetarët. Këto dy bashkë nuk shkojnë. Unë po ju bëj thirrje, kryeni punët e juaja që i keni përgjegjësi, por mos merrni tjera gjera nëpër gojë", konstatoi anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se e para, edhe unë si kryesues i Kuvendit, edhe PDK, nuk e ka as të drejtën, as moralen, as kurrgjë të adresojë personale në vendimet e përgjithshme që bëjnë institucionet. E aq më tepër drejtorët që janë në ekzekutiv kushdo qofshin ata se këtu nuk ka zgjidhje personale. Unë nuk besoj që ka drejtor duhet ashtu t'i adresojë, së paku unë nuk flas për ata që në moment të caktuar nuk mund ta

kontrollojnë veten, por drejtorët dhe ekzekutivi dhe ne duhet për të qenë të përgjegjshëm që këtu nuk ka vendime individuale, edhe nuk ka për hatër ose jo hatër, por ka vendime kolektive që bien në institucion me një votë. Ju e dini që edhe kryesuesi në këtë rast unë kam në momente të caktuar kam votën e dyfishuar, kur është rezultati i barabartë në votim, përndrysht as unë as ju individualisht askush nuk përfaqësoni më shumë se sa një votë në vendimin e përgjithshëm që e merr kjo asamble si kolektivitet. Këtu askush nuk e merr si individ, por si kolektivitet. Kjo qasje për mua është brengosëse, në qoftë se individ të caktuar përfaqësojnë këto institucione, qoftë në ekzekutiv, qoftë legjislativ, qoftë i vetmi këshilltar, që e personalizon vendimin e përgjithshëm institucional me një qëndrim personal edhe t'i josh qytetarët në drejtim të caktuar unë publikisht distancohem prej atij qëndrimi, kushdo qofshin ata njerëz. Prandaj nuk ka askush të drejtë, asnjë subjekt, asnjë individ, në këtë rast në PDK të adresojë se mundet PDK-ja jo të jap leje ose të mos jap. PDK-ja ka shumicën, por vendimmarrja është kolektive, institucionale që e përcakton ligji mbi vendimin. AK ka marrë një vendim për atë zonë, ato vendime AK nuk mundet për çdo ditë të marr vendim mbi vendim, vendim pas vendimi, vendim në fuqizim të vendimit. Domethënë të jemi të përgjegjshëm në këtë punë dhe janë instancat tjera të cilat duhet atë vendim ose vendimet që i marrim t'i zbatojmë dhe i nënshtrohen rregullit që ka vendosur kushtetutshmëria e Republikës së Kosovës. Prandaj unë mendoj që nuk duhet në personale kurrgjë as grupore, por thjesht institucionaliste. Edhe unë ftoj edhe për debate tjera, kur kemi pasur debate të emërtimeve të rrugëve, dhe debate tjera ku na lidhen edhe interesat tjera personale familjare tona. Thjesht të kemi qasje institucionaliste. Unë po flas për vete unë kam pasur rast të tillë kur kam kërkuar institucionalisht për t'u përgjigjur ndaj një të afërmëtim. Prandaj nuk lejoj, po flas për vete, dhe grupimit politik ku jetoj, etiketimin që mund, ne, PDK-ja në momente të caktuara t'i bëjë dikujt me gisht se iks ose ipsiloni po bllokoni vendime”, ka nënvizuar kryesuesi Ibishi.

**Rasim Millaku**, tha se do të flas për këtë zonë ndërtimore se unë kam qenë për 6 vjet drejtor i Inspektoratit, organi i cili me ligj ka qenë i obliguar t'i mbikëqyr ose t'i ndalojë ndërtimet pa leje, d.m.th të gjitha ndërtimet që i sanksionon ligji mbi ndërtimet. “Do të prezantoj gjithçka çfarë di dhe çka kam kaluar gjatë asaj periudhe sa kam qenë drejtor, pa dashur të shfajësohem në asnjë moment, por as të marr përgjegjësi ku nuk ekzistojnë. Për herë të parë, po me vjen mirë që po i shoh dy dokumente që KK në Klinë të vitit 2006, që thuhet janë 9 shtëpi, nuk do të hyjë në numra. Faktikisht vetëm nëse me një ekzemplar shkelet ligji, nuk është më pak i vogël ose më i madh nëse rastin tjetër shkelet me dhjetë ekzemplarë, kisha thënë me ndërtim të shtëpive. Këtu sugjerimet po më pëlqejnë, edhe unë si drejtor i Inspektoratit për 6 vite sa kam qenë t'i kisha parë këto vendime me siguri kisha bërë presion që këto rekomandime për t'i qitur në ekzekutim, sepse ajo zonë nuk është as më pak, as më shumë se sa shumë zona ndërtimore që ka Kлина, po flas për tokën me vlerë. Unë vij nga një fshat që quhet Ujëmir që nuk e ka tokën më të dobët fare, por kisha për të thënë më të mirë se sa zona e Dresnikut këtu. Për t'u sqaruar të gjitha këto, gjatë gjithë kohës edhe televizione kam pasur në zyrë, gazetarë vendorë dhe më larg, dhe thirren ose domin ta ruanin këtë tokë nga diçka se unë kurrë se kam parë. Unë gjatë gjithë kohës, kushtimisht po e them me një përkushtim shumë të madh, kam qenë i interesuar për ta ruajtur atë zonë, se dëshiroja ta respektoj ligjin dhe më tepër se për 1 vit nuk kam gjetur asgjë, pastaj më ka rënë pak intensiteti i angazhimit tim për shkak se nuk kam ditur çka të ruaj. Më saktë, në ato zona kur Kлина ka qenë e urbanizuar unë jam i vetëdijshëm se dikush e tha këtu më herët, se përgjegjësia nuk vjetrohet. Ne po flasim, po konsumohemi, po lodhemi rrëth një vendimi që paska marrë dikush dhe nuk e kemi të shkruar. Dhe kur do të ruash duhet të thuhet: “Ja ku është ky vendim, ja ku është kjo hartë!” Po kthehem edhe tek këta banorë që kanë bërë këtë peticion. Po të isha drejtor do të kisha ditur çfarë të veproj. Nuk po i njoh të gjithë, por shumicën po, vetëm e di një çështje se pothuaj të gjithë aty kanë shtëpi të ndërtuara. A po shkojnë t'u ndërtojnë në tokë të atyre apo po ndërtojnë vetë. Po thirrin organin:”Ejani mos na lejoni për të bërë shkelje!” - kushtimisht po them. Të gjithë kanë shtëpi nëpër ato zona. Unë

s'kam pronë, po të kisha pasur kisha ndërtuar, sepse është shkelje e të drejtave të njeriut nëse shteti ynë, komuna jonë thotë "mos ndërto shtëpi në pronën tënde se është rezervat bujqësor dhe nuk jep atij asnë alternativë. Këtu është atakuar edhe Drejtoria e Gjeodezisë, me të drejtë apo pa të drejtë, mirëpo edhe ligji i parcializimit është shumë e saktë që nuk njeh ligje tjera. Ai thotë: "Është e ndaluar me ligj". Po sikur të ishim të koordinuar të gjithë ne për ta ruajtur atë zonë, kisha thënë që ai organ që ka lëshuar me ripërtëritjen e organit tonë pas lufte, duke e parë që ajo zonë më të vërtetë ka nevojë për ta ruajtur, ta bëjë një studim për atë tokë edhe ta marr në konsideratë. Shumë po më pëlqen të jetë e kujdoqoftë se ka ndodhur çka ka ndodhur, tash të shikojmë si ta parandalojmë trendin e ndërtimeve. Për herë të parë po shoh këtë raport të ekspertëve, i cili veç iu ka rekomanduar URBAN + dhe për çudi URBAN + ka marrë para nga atëherë dhe tash po vazhdon të marr dhe nuk i ka zbatuar këto rekomandime. Domethënë ka kaluar mirë dhe lehtë përmes gishtave tanë, ka marrë paratë e tenderit dhe nuk kanë studiuar saktë atë zonë, sepse aty nuk e di edhe URBAN +, a ka pasur vendimin e ndalimit si rezervat bujqësor që po i thuhet kush e ka shpallur. Shumë e kisha lutur këtë Kuvend, e kam lutur edhe Kuvendin e mëhershëm, ta kam atë vendim si drejtor, po e konsideroj veten, po dua ta quaj veten jam drejtor i Inspektoratit. Në këtë zonë gjithmonë kanë ndodhur ndërtime edhe më herët, menjëherë pas lufte intensiteti ka qenë më i vogël. Për inspektorët kam konsideratë që punojnë me përkushtim dhe qysh në fillim i kam rekomanduar që të më dorëzojnë numrin e shtëpive me nënshkrim të gjithë. Është një numër shumë i madh që as nuk më shfajëson mua, kam dashur të di se çka po pranoj. Prandaj, nuk di çfarë të ruajmë në atë zonë, Ligji i ndërtimit e ndalon çdo ndërtim në klasën e I,II dhe III, çdo tokë bujqësore ligji e ndalon, por sa kemi mbërrri standardin t'u ofrojë alternativë qytetarëve të Kosovës dhe t'i thuhet "ti ke tokën e mirë. Kлина ka tokë bujqësor të bollshme edhe për të bashkëpunuar me pronarët e atyre tokave, mos të parcializohet ajo tokë fillimi dëshirojmë t'u ofrohet një banim duke e ditur nevojshmérinë e banimit. Gjendja ekonomike e banorëve të Klinës thotë që secili banor në tokë të yet duhet të ndërtojë. Nëse nuk ka alternativë tjetër ky nuk është ligj i shkruar por ligj moral. Ju kisha bërë thirrje të studiojmë saktë, që të studiohet në nivel të ekspertëve edhe komunal edhe jashtë të shihet çfarë mund të bëjmë në atë zonë se ia vlen për ta ruajtur si rezervat bujqësor. Përndryshe të njëjtën tokë po e humbim gjithandej Klinës, nuk jemi duke humbur në Dresnik, apo Dollc, por po e humbim edhe në Klinë, edhe në Ujëmir etj. Propozoj, po që se ka vullnet edhe ky ekzekutiv bashkë me të gjithë referuesit të deritanishëm për ta marrë gjendjen ekzistuese dhe të niset edhe një rekomandim i ri, por për ta zbatuar rekomandimin. Ose, po që se dëshirojmë të jemi aq zbatues të ligjit s' po shohim në bazë të cilit vendim për t'i rrënuar. Por një vendim që nuk shihet çka të ruhet, kujtoj që më 2006 është marrë një vendim vetëm në thonjëza nga ajo që është folur, por s'e ka pasur Asambleja, e kaluar që iu ka referuar URBAN + le të vazhdohet të jetë ajo zonë ndërtimore, edhe rezervat bujqësor pa pasur një studim paraprak deri ku të shkojë ajo zonë. Prandaj nuk e kemi në dorë ne ose nuk e ka pasur as Asambleja e kaluar, as e tashmja asnë hartë diku ta ndalojë ose diku të ruajë këtë tokë bujqësore", na konstatuar anëtari Millaku.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se pajtohem me këto konstatime. "Edhe këto rekomandime që paskan qenë prej grupit të ekspertëve paska pasur hapësirë me propozimet e tyre për t'u bërë zgjidhje".

**Kolë Prenaj**, tha se sot jemi duke debatuar një çështje që është zvarritur. "Ish-drejtori i Inspektoratit dha shumë sqarime konkrete. Falënderoj Ndoun që bëri një propozim shumë të mirë, që ka ndodhur çka ka ndodhur. Ne jemi së bashku për mbrojtjen e interesave të qytetarëve të Klinës, të gjithë e duam Klinën, edhe me mundësinë e bashkëpunimit. E falënderoj edhe Fadilin që ka bërë një sqarim që më 2006 një vendim i marrë nga AK është vendim enigmatik. Shumë mirë e tha Rasim, i mos kemi bërë ne shkelje që kemi penguar, apo që i kemi gjobitë nga pak. Ky peticion nuk kërkon diçka më shumë se sa parandalimin e ndërtimeve. Këto vendime me insistimin tim personal janë nxjerrë. Sa i përket parandalimit me drejtorin e Kadastrit kemi biseduar që të mos parcializohen. Si të parcializohen tokat humb kuptimi i tokës bujqësore. Janë munduar të pengojnë, janë formuar edhe agjencionet gjeodezisë

private që nuk pyesin. Me MAPH sa herë kemi shkuar dhe biseduar me sekretarin permanent z. Arben Çitaku, a ka model të mundësisë së ndalimit të parcializimit të tokave bujqësore? Mirëpo ata nuk me janë përgjigjur asnjëherë. Kështu që, edhe drejtori i Kadastrit kur ka parë çështjes se si është duke shkuar pas 6 muajve që kemi ndërmarrë njëfarë pengimi nuk ka pasur mundësi që të ndalojmë. Çka tutje? Pyetje shumë konkrete, e sinqertë. Komuna kadastrale është lumi Klina, Ura e Haxhisë deri në Dollc, edhe vazhdon mbi transitin Gjakovë-Skenderaj. Rezervat bujqësor ka qenë. Një vendim që është marrë në të kaluarën, ndoshta ligji i ri për trajtimin e ndërtimeve pa leje që është nxjerrë më 5 shkurt 2014 rrëth legalizimit të tokave që nuk kanë leje, këtu hyn edhe zona urbane edhe zona rurale. Sipas shënimve që posedojmë gjendja në Klinë është më mirë se kudo në Kosovë. Në zonën që u potencua 23 ndërtime janë bërë më 2006-2007. Për momentin janë rrëth 110 ndërtime në atë zonë siç është quajtur: Rezervat bujqësor. Çka është shqetësimi tjetër, a do të legalizohen shtëpitë që janë nën ujitje, që janë komasacion që është ndalim i ndërtimit, si dhe klasa I dhe II që ka të njëjtin tretman. Kërkoj përkrahje nga asamblistët që për këtë çështje për një periudhë të caktuar të merret një qëndrim konkret. Në këtë peticion janë nënshkruar qytetarë të Dresnikut, të Dollcit, të Klinës, Përlinave etj. Nuk ka ndonjë skenar me qëllim të keq këtu, por iniciativa është qëllimmirë. Ne jemi dëshmitarë që kemi një rezervat të trashëgimisë kulturore në atë pjesën e Dresnikut, diku rrëth 30 hektarë. Me propozimin e qytetarëve të Dresnikut edhe rruga që shpie andej është emërtuar "Qyteti Antik". Për të mos u ndërtuar në këtë zonë dhe në zonat tjera bujqësore edhe publikimet nuk kanë munguar përmes medieve, sidomos përmes Radio Alba dhe shpalljes në tabelën e Komunës. Krejt duke u bazuar edhe në Ligjin e ri dhe Udhëzimin Administrativ i dalë nga MAPH, që është sponsorizuar nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Europian, OSB-së dhe USAID-it. Ligji do të zgjat 3 vjet rrëth trajtimit të ndërtimeve pa leje. Të formohet një grup punues në bashkëpunim me Zyrën ligjore dhe të sjellin vendimin, ndalohet apo nuk ndalohet. Pastaj ekziston edhe ai projekti i rrugës transite Gjakovë-Klinë-Skenderaj që do të kalojë përmes Dresnikut, atje kemi rezervatin e trashëgimisë, prandaj të mendohet për ruajtjen e atij rezervati të trashëgimisë dhe të vihen pikat e ndërtimeve afér rrugëve, që mos të kemi probleme në të ardhmen, që zgjerimi i rrugës mos të jetë i penguar nga ndërtimet ", nënvízoi ndër të tjera drejtori Prenaj, i cili edhe më tutje sqaroi shumë çështje të tjera tematike.

**Fadil Gashi**, foli rrëth çështjes në debatim. "Po e bëj një dallim, qenka bërë në atë kohë kur është marrë vendimi, mos e përzini drejtor, vendimi është tjetër, për PZHU, e raporti, aneksi, dokumenti, që i bashkohet raportit është diçka tjetër. Nuk mund të thuash se paskan pasur të drejtë qytetarët për të ndërtuar. Ky është një sugjerim që iu ka dhënë kur është miratuar ky vendim, Kuvendi e bën këtë sugjerim që në të ardhmen t'i ketë parasysh çka mund të ndryshohet e çka mund të bëhet. Ky është raport që ka dalë nga ai Kuvend, por nuk është vendim, këtë dallojeni. Te peticioni i qytetarëve askush nuk mund të thotë se nuk kanë të drejtë, ata po kërkojnë për të respektuar çka ne jemi të obliguar. Po të kishte ra ndesh me vendimin tonë, se këtu tash peticioni është në harmoni me vendimet e këtij organi. Po këtu në peticion kam parë nuanca, mund të gaboj, se ky ka më shumë faj, jo ky më pak faj. Unë po bëj një pyetje konkrete: Kush e ka fajin që keni shtruar asfaltin dhe keni hyrë në zonë bujqësore andej, tash asnjë muaj se ka? Asfalti është shtruar, ka hyrë në zonë bash për këto kohë që kemi fjalën. A më fortë është bërë ajo shkelje apo parcializimi që nuk çare pa e bërë. Po e marr kërkësen që është bërë në peticion. Se parcializimin nuk mund t'ia ndalosh askujt, sepse nuk ke të drejtë me ligj. Peticioni është krejt në harmoni me atë që po kërkojmë ne prej Kryetarit dhe komplet nga ky Kuvend, këtë jemi duke kërkuar. Qysh e gjejmë zgjidhjen mirë është me krejt ato institucionë për t'u konsultuar, por gjendja në terren u është krijuar. Si të doni e qesim në peshore kush më shumë e kush më pak ka faj. Tash është e dhimbshme edhe me atë ndërtim që është bërë. Ajo kosto që është investuar është djersë e qytetarëve që kanë derdhur aty. A me faj apo pa faj me të drejtë apo pa të drejtë gjendjen faktike e kemi të krijuar. Çka mund të bëjmë duhet gjetur ato shtigje", pohoi ndër të tjera anëtarë Gashi.

**Kolë Prenaj**, (lexoi vendimin). “Askush nuk mund t’i ikë përgjegjësisë. Të mos i marrim gjerat as personale , as në mënyrë tendencioze. Edhe unë po e ritheksoj atë që thanë me parë dy parafolësit, ka ndodhur çka ka ndodhur, por tash çka mund të ndërmarrim dhe për të parandaluar. Nuk është vetëm kjo zonë e Dresnikut. Kлина ka edhe shumë zona tjera të cilat janë zona të interesit dhe ligji ta ndalon. Ne është mirë për të paraprirë përpara për të mirë për Klinën. ”, shtoi drejtori Prenaj.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se Asambleja komunale është në të njëjtën vijë me kërkesën e qytetarëve për zbatueshmërinë e ligjit. “Edhe unë nuk kam më shumë çfarë të shtojë përpos asaj, të një apeli sigurisht prej gjithë juve që të respektohen vendimet që kjo Asamble komunale ka prurë në kontinuitet. Edhe ato vendime nuk mund të bihen vendim mbi vendim për të njëjtën çështje”, theksoi Kryesuesi.

**Sokol Bashota**, foli rreth çështjes në shqyrtim dhe debatim. “Më lejoni fillimi t’i uroj asamblistik më të ri të kësaj legjislature z. Petrit Palushi për detyrën që ka marrë. Besoj se do të jetë zë i fuqishëm i votuesve të tij edhe i qytetarëve të tjerë të Komunës së Klinës, ku e ka derën hapur për të trajtuar dhe për të adresuar çështje të cilat janë në interes të qytetarëve.

Gjendja që është në atë zonë as nuk e kemi gjetur mirë, as nuk kemi pasur mundësi ta mbajmë mirë për të vazhduar me të njëtin trend. Ajo që thuhet këtu është po qitet në bankën e të akuzuarve, se cila legjislaturë, cili kryetar, cila administratë a asamble ka marrë një vendim të atillë apo të këtillë. Çështja është se çka më tutje, por edhe çka për ato që janë se është derdhur një djersë e madhe e qytetarëve aty. Realisht ne Klinën po e njohim dhe po e dimë të gjithë dhe i dimë mundësitë dhe hapësirat që kah dhe në cilën pjesë Kлина nesër apo pasnesër ka për t’u paraqitur si domosdoshmëri e shtrirjes së qytetit. Por, në qoftë se edhe në atë formë ashtu qysh është nuk ndërmarrim disa masa për të rregulluar të paktën infrastrukturën nesër ata me ato ndërtimë duke u munduar për të shfrytëzuar edhe vakuumin ligjor, por edhe duke u munduar për të shfrytëzuar çdo hapësirë që kanë, kanë për t’ia zënë fryshtëvet.

Thjesht kanë për ta penguar njëri – tjetrin. Do të kishte qenë mirë, që edhe Urbanizmi në këtë rast, edhe Inspektorati bashkë me Gjeodezinë për t’i trajtuar këto mundësi që nesër ka për t’u paraqitur nevoja e unazës së qytetit, e cila tash do të lidhet me autostradën që po vazhdon në drejtim të Pejës dhe ju e dini që për trasim të re që ka ardhur dhe realisht duhet për të ditur se ku është më funksionale për t’u kyçur në atë autostradë. Dhe, gjithmonë, ajo autostradë të mos jetë gjithmonë zorrë qorre, gjegjësisht Kлина të mos jetë një zorrë qorre e asaj rrugë të mos i ketë mundësitë e kyçjes adekuate, por t’i krijojë mundësi vetes se më vonë të jemi të sigurt se nuk do të kemi për të pasur mundësi. Ne jemi duke i trajtuar mundësitë që rruga që ka ardhur deri në Zallq, që ka ardhur rruga e Pejës ta kalojë këtë unazën në drejtim të Istogut edhe këtë pjesën e Lugut të Drinit për ta lidhur me Grabanicën diku, në qoftë se veç kemi mundësi, por duhet për ta menduar edhe këtë pjesën tjetër që shkarkon Prishtinën, Gjakovën dhe pjesët tjera që vinë në rrugë në drejtim të Skenderajt dhe për Istog. Nëse nuk ndërhyni shumë shpejt do të ndodh shumë keq. Rrugët që janë në kadastër unë i kam shikuar ato dhe janë rrugë që janë marrë me fotografime nga aeroplani, ku gjendja ekzistuese e atyre rrugëve është shumë e keqe, rrugët janë shumë të ngushta. E kemi edhe kërkesën që kemi për unazën, prandaj ekzistojnë mundësitë që të ndalohet, përkatesisht ka mundësi që qeveria të mos e financojë atë pjesë, atë unazë për shkak të kostos së lartë. Kështu që, duhet marrë parasysh këta parametra, ajo rrugë që është bërë asfalt janë qytetarë të Klinës, është rrugë që është ndërtuar jo në pronë bujqësore, por është rrugë që ekziston me kadastër. Unë raportin që është bërë atëherë është bërë me qëllimin më të mirë, ky raport është një këshillë një sugjerim mbi gjendjen ekzistuese që ka qenë atëherë, prandaj këtë veprim edhe sot kisha bërë. Cilësdo kompani projektuese i kisha sugjeruar që t’i keni parasysh këta parametra se gjendja është kështu. Ligji ekziston, këtë po e kërkojmë absolutisht. Urbanizmi, Gjeodezia, Inspektorati, vetëm ta zbatojnë ligjin. Tjetër gjë këtu nuk ka. Dhe kjo kërkesa e qytetarëve a është tendencioze apo nuk është, se këtu edhe politikë bëhet, që më së paku kisha dëshiruar të bëhet politikë, apo për ta quajtur politikë iniciativë e qytetarëve, të cilët kërkojnë për të respektuar ligjin, në një. Dy, është pjesa tjetër më shqetësuese, po që

se ne merrem vetëm me këtë çështje dhe harrojmë qytetin brenda. Gradualisht me ndërtim qytetarët duhet respektuar parametrat e shfrytëzimit të hapësirës që kanë për ndërtim. Përndryshe, jo veç neve, por vvetvetes kemi për t’ia zënë fryshtë me ndërtim. Unë shoh shumë të nevojshme që në një takim me shefat e GP, pikërisht këtë çështje për ta diskutuar në me trajtim të veçantë për të ardhmen e kësaj zone. Duke u nisur mbi bazën që kemi sot, duke i parë mesazhin çfarë e çojmë nesër për qytetarët dhe për ta marrë një hap, pastaj për të ta bërë strikt. Parcializmin nuk e ndalon me ligj, Zeqa veç e shpjegoi, megjithatë është mirë të paktën për ta bërë një plan, një mundësi të paktën të negocimit jashtë të vijave zyrtare për shkak të ruajtjes së disa hapësirave për kryeje në hapësirë”, ka nënvizuar kryetari Bashota. **Haxhi Ibishi**, tha se ne kemi edhe një kërkesë për emërtimin e një rrugë në Shtupel. “KPF ka preferuar që ky emërtim i një profesori të nderuar që ka qenë i atij lokaliteti të hyjë në listën rezervë që ka miratuar AK. Është rasti për Fazli Jakupin, lagja e tij kanë kërkuar që në Shtupel një rrugë të emërtohet me emrin e tij. Propozimi është që emri i Fazli Jakupit për t’u vendosur në listën rezervë të emërtimeve të rrugëve. Kështu ka qenë qëndrimi i të gjitha grupeve kuvendare në KPF”, sqaroi Dr. Ibishi.

**Arben Limani**, theksoi se kërkesa të këtilla kemi për të pasur edhe në të ardhmen, prandaj mendoj që do të kishte qenë mirë që kërkesat të tilla të na drejtohen neve si komision.

**Haxhi Ibishi**, sqaroi se komisioni ka përfunduar punën. “Do të formohet një zyrë që do të merret me këtë çështje”.

**Skënder Merturi**, tha se më ka rënë për ta parë hartën e emërtimeve të rrugëve të reja që është bërë dhe kam vërejtur në këtë hartë që është bërë ndryshimi i emërtimeve të rrugëve që kemi miratuar në këtë Asamble komunale. “Kisha kërkuar që të na jepet një shpjegim pse është ai ndryshim i atyre rrugëve në hartë kur ne kemi votuar listën komplet, prandaj emërtimet në atë hartë nuk janë njëjtë ashtu qysh është vendosur në listë”, theksoi anëtari Merturi.

**Haxhi Ibishi**, sqaroi çështjen. Posa të jetësuhet zyra për emërtimin e rrugëve, ministria e linjës nuk na ka sjellë konfirmimin e emërtimeve bazike kushtimisht e them të atyre emrave që kemi vendosur. Unë s’po di nga ka ardhur ajo hartë, ende nuk janë të konfirmuar emrat që kjo asamble emërtimet e rrugëve që i ka marrë vendim. Kjo asamble do të ketë edhe një raport të zyrës së emërtimeve mendoj që do të debatojmë”, shtoi kryesuesi i cili në vijim vuri në miratim rekondimin e KPF-së, që emri i Fazli Jakupit të përfshihet në listën e emrave rezervë për emërtimin e rrugëve.

**Me vota unanime u miratua rekondimi.**

**Pika e tetë: Propozimi i Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimit për emërtimin e Palestrës Sportive me emrin e Komandantit Legjendar Adem Jashari.**

**Kryesuesi Ibishi**, foli rreth çështjes. Kryesuesi propozoi që Propozimi i Kryetarit të Komunës për marrjen e një Vendimi për emërtimin e Palestrës Sportive me emrin e Komandantit Legjendar Adem Jashari të përfshihet si pikë e veçantë (plotësuese) e rendit të ditës për shkak të rëndësisë që ka marrja e një vendimi të tillë në këtë seancë. Kryesuesi, po ashtu sqaroi se përrurimi i Palestrës Sportive pritet të bëhet në vigjilje të 28 Nëntori – Ditës së Flamurit Kombëtar, prandaj për t’i zënë afatet ligjore për kohën kur do të përurohet kjo palestër sportive dhe marra e Vendimit për emërtimin e saj me emrin “Adem Jashari”, do të ishte e arsyeshme që këtë çështje ta vëmë si pikë e veçantë e rendit të ditës dhe ta miratojmë në këtë seancë.

**Kryesuesi fjalën e barti te Kryetari i Komunës së Klinës, Sokol Bashota.**

**Sokol Bashota**, tha se ne paraprakisht e kemi diskutuar edhe në kur janë bërë emërtimet, me Ministrinë e Kulturës jemi duke i finalizuar punimet në Palestrën Sportive. “Nuk di nëse kemi mundësi të takohemi edhe në një seancë tjeter, paraprakisht që të përgatitemi për një propozim që ka qenë për

palestrën, pasi që me emrin Adem Jashari nuk ekziston asnjë emërtim i rrugëve, të shesheve dhe asnjë objekti, prandaj më herët është propozuar që Palestra Sportive të ketë emrin e komandantit legjendar Adem Jashari. Në qoftë se bëhet inaugurimi i kësaj palestre, ministri i Kulturës thotë se deri më 28 Nëntor do të jetë gati, Komandanti Legjendar Adem Jashari në këtë ditë edhe ka ditëlindjen, do të ishte mirë që kjo Asamble të marr një vendim për emërtimin me këtë emër të kësaj palestre sportiv me emrin “Adem Jashari”, theksoi kryetari Bashota.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se kemi hapësirë të mjastueshme. “Me kalendar do të kemi mundësi të mbërrimë në afatin e caktuar.

**Haxhi Ibishi**, kërkoi nga shefat kuvendarë që të deklarohen rreth propozimit të Kryetarit të Komunës, që Palestra Sportive të emërtohet me emrin “Adem Jashari”.

**Tunë Dedaj**, deklaroi se do të kishte qenë mirë që ky propozim të kryhet sot në këtë seancë, prandaj, edhe se nuk ka nevojë një seancë tjetër për arsyen Adem Jashari meriton që ajo palestër ta ketë emrin e tij”, shtoi z. Dedaj.

**Halil Desku**, theksoi se ne Grupi i anëtarëve të PDK-së jemi pro propozimit të Kryetarit, edhe ashtu kryetari përfaqëson qëndrimin tonë.

**Fadil Gashi**, theksoi se nëse e meriton për Adem Jasharin sot gjithqysh për ta vendosur, unë mendoj që përkundrazi ai e meriton edhe një seancë tjetër. “E meriton dhe po që se keni përtesë për të ardhur, atëherë gaboni. Nëse është figura e Adem Jasharit ose për cilindo dëshmor tjetër, pse kemi nevojë për të shkelur procedurat? Pse të mos kalojë përmes KPF-së. Nuk mendoj që ka ndonjë miop këtu që mendon ndryshe këtij mendimi apo vendimi, por e meriton ai për të respektuar”, tha anëtari Gashi.

**Haxhi Ibishi**, tha se propozimin e kemi kaluar nëpër KPF, është propozim i vjetër.

**Fadil Gashi**, tha se nëse ka qenë edhe tash vjen në KPF dhe procedojmë, mirëpo bash kështu ad oc mos na e qitni, të krijohen përshtypjet se dikush është pro apo kundër”, shtoi anëtari Gashi.

**Sokol Bashota**, tha se ky propozim ka kaluar të gjitha procedurat, ka qenë në KPF, është votuar në tërësi, është mbetur momenti kur bëhet e gatshme palestra dhe për t'u zyrtarizuar përmes Asamblesë komunale. “Prandaj ka kaluar procedurat e rregullta, të gjitha. Tash ministri tash zotuar të gjitha mjetet e nevojshme, bile – bile pa përjashtime ka dhënë mjetet edhe ankesë për t'u bërë edhe oborri i saj. Kështu që procedurat ligjore janë tejkaluar, a vendosni sot, apo në seancën e tjetër varet prej jush, vetëm do të ishte mirë ta akordohemi me agjendën e ministrit që ka shprehur dëshirën për të qenë pjesëmarrës edhe në inaugurim, ndodh që përvimi të bëhet më herët. Do të kishte qenë mirë që për shkak të përgatitjeve të nevojshme të miratohet në këtë seancë, pasi që edhe ashtu të gjitha procedurat janë tejkaluar”, shtoi Kryetari.

**Haxhi Ibishi**, foli rreth çështjes dhe përkrahу propozimin e Kryetarit. “Kjo është çështje konsensusiale, edhe ne e kemi kaluar nëpër KPF, edhe pjesën formal-juridike të emërtimit të palestrës e kemi kryer. Po që duhet një vendim i AK. Në qoftë se dakordohemi të gjithë janë dy propozime, i Tunës edhe i Fadilit, Tuna po thotë po procedojmë sot, qëndrimin e kryetarit dhe të PDK-së është për cilëndo variant, por propozimi është për sot, si dhe Fadili për një seancë solemne siç po i bie kështu të asamblesë. Po që se jemi të dakorduar të gjithë më mirë do të ishte që sot ta bëjmë emërtimin”, pohoi Kryesuesi.

**Arben Limani**, në emër të Grupit të anëtarëve të LDK-së e përkrahim propozimin.

**Haxhi Ibishi**, tha se me propozim të kryetarit vendoset si pikë shtesë në AK vendimmarrja për emërtimin e Palestre sportive me emrin Adem Jashari.

Kryesuesi vuri në miratim propozimin.

Propozimi u miratua me vota unanim.

Kryesuesi vuri në miratim propozimin e Kryetarit të Komunës që Palestra Sportive në Klinë të emërtohet me emrin e Komandantit Legjendar “Adem Jashari”, përvimi i së cilës palestër do të bëhet në vigjilje të 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit Kombëtar.

**Me 25 vota për, 1 të përmbajtj u miratua propozimi i Kryetarit të Komunës që Palestra Sportive në Klinë të mbajë emrin e Komandantit Legjendar “Adem Jashari”.**

**Pika e tetë: Pyetje dhe përgjigje.**

**Haxhi Ibishi**, tha se e kemi krijuar këtë praktikë, të cilën ndoshta do ta përpunojmë me kryetarët e GP për të mos na marr shumë kohë.

**Haxhi Ibishi**, tha se Afërdita Gashi, ka pyetur ekzekutivin për psikolog. “Përgjigja u mor, e dha drejtori i DKA-së. Shukrije Shala, të gjithë e dimë që sheshi “Faruk Elezi”, dhe hapësira është e zënë prej qytetarëve ku ka edhe dry për shitje. Mendoj që edhe organet gjegjëse duhet të bëjnë diçka konkrete që hapësira të lirohet.

**Kolë Prenaj**, tha se ky shqetësim është shumë i hershëm, por edhe qytetarët janë në pozita të vështira. DSHP ta sjell një qëndrim, përkatësisht ekzekutivi. Nuk është e lehtë të ekzekutohet pa e ditur se ku do të përcaktohem për vendin e vendosjes së druve dhe gjësendeve tjerë”, sqaroi drejtori Prenaj.

**Sokol Bashota**, tha se publikisht po të them se të respektohet ligji dhe brenda tre ditëve të zbatohet ligji.

**Haxhi Ibishi**, theksoi e shqetësim tjetër ka lidhur me SHMT “Fehmi Agani dhe “Motrat Qiriazi”, mendoj që prezenca e policisë është e nevojshme sepse ndikon në parandalimin e konfiktve të nxënësve. Shqetësimin ka shprehur këshilltarja Shukrije Shala. Kryetari që ka takimet me komandantin mund të ngrit si shqetësim.

**Kolë Prenaj**, tha se me të vërtetë ka pengesa, sa është efekti i tyre pozitiv, javën e kaluar kemi marrë një raport diku 50 për qind ka ndikuar në evitimin e aksidenteve dhe ekseseve tjera. “Në pjesën e territorit të Klinës këta policë të shtrirë i kemi vendosur në bashkëpunim me shërbimin policor të Klinës. Jemi marrë vesh edhe me departamentin gjegjës të Ministrisë së Transportit dhe na është thënë që pengesat të mos janë më të larta se 3 cm dhe ne iu kemi përmbajtur këtyre parametrave të lartësisë. Nuk qëndron konstatimi se janë vendosur në ato zona ku jetojnë udhëheqës politike, ne i kemi vendosur në ato vende ku ka pasur më së shumti aksidente. Mendoj që është një investim i mirë dhe nuk ka diçka të keqe, nuk është çmimi i shtrenjtë i tyre, kualiteti është shumë i mirë, kontrata për ekzistimin e tyre është për dy vjet, mendoj së qëndrueshmëria e tyre do të jetë edhe më e gjatë”, ka konstatuar drejtori Prenaj.

**Lorenc Marleku**, tha se i takoj kësaj lëmie edhe ju sigurisht nëpër qytete tjetra lëvizni dhe mund të vëreni se barriera të këtilla nuk ka të vendosura. “Në Istog nuk është asnje, në gjithë Pejën janë vetëm dy, në Klinë të bëhet kësi invazioni nuk është në rregull, që për mua janë barrikada. Kemi kaluar kohën e barrikadave. Këto vendosen në ato pika ku këndi i vdekur është shumë i padukshëm. D.m.th. hyrja në një rrugë nuk duket në të dy anët, aty mund të vendoset. Po që se vendosen në 300 metra dy, këto janë krejt të pakuptimita. Dhe me këtë po doni të thoni se këtu ka dështuar policia. Pse është policia? Pse është kufizimi i shpejtësisë? E dyta, te “Semira” vendoset shenja e komunikacionit, vendkalim i këmbësorëve edhe shenja vertikale dhe horizontale dhe kufizimi i shpejtësisë është 60 km/h. Kur të vendoset ajo shenjë, shpejtësia duhet të jetë shumë e ulët. Kjo është në kundërshtim me ligjin e komunikacionit dhe në një të caktuar moment mund të shkaktohet edhe aksidenti. Tjetër shqetësim kemi në rrugën magjistrale në fshatin Grabanicë, ku është e vendosur shenja treguese për Deçan, që është veprim tërësisht i jashtëligjshëm. Në atë drejtim kah tregon kjo shenjë janë edhe Tirana, edhe Roma. Prandaj ajo shenjë duhet të hiqet urgjentisht. Se mund të vije ndokush nga Tetova dhe për të shkuar për Deçan merr atë drejtim! Shumë e pakuptimtë është ajo. Pra, për të gjitha këto duhet konsultim me ekspertë të komunikacionit, në mënyrë që të mos krijojmë huti tek qytetaret”, theksoi

anëtari Marleku.

**Haxhi Ibishi:** "Fadil Gashi pyet: a ka kush të na sqaroi në seancën e radhës çfarë është duke u bërë me objektin përballë, se këtu ka një vendim të Kuvendit, çfarë destinomi ka dhe për çka duhet për t'u përdorur ky objekt?"

**Baki Gashi**, sqaroi pyetjen. Drejtori Gashi tha se sa i përket këtij objekti ajo që është duke ndodhur realisht është duke i krye punët në bazë të lejes së ndërtimit. "Më e rëndësishme është që projekt-ndërtimin me Komunën e kemi përfunduar marrëveshjen e koncesionit ku realisht komuna me vullnetin e plotë të kompanisë, përkatësisht të konsesionerit ka përfituar edhe 70 e diçka metra katrорë më tepër se sa i takon, ndërsa sa i përket pjesës së vet për sa është ai pronar ai është duke i përfunduar punimet", sqaroi drejtori Gashi.

**Fadil Gashi**, tha se drejtori nuk ka sqaruar asgjë, absolutisht asgjë s'ka sqaruar! "Te pengesat në rrugë, unë kam bërë një kërkësë në seancën e kaluar të na sillet edhe një te banesat. Është e vrazhdët të shihen ato pengesa. Më shumë defekte janë duke bërë. Pengesat në rrugë nuk i ndalin vdekshmëritë në rrugë. Sidomos këto ku janë të vendosura janë të vrazhda. Të institucioni i shkollës janë mirë që janë vendosur, mirëpo policia kur nuk mund ta ruajnë veten, ata para vetes e kanë vendosur", pohoi anëtari Gashi.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se tjetër pyetje është tenderi i DKA-së duke anashkaluar ZP, transporti i nxënësve.

**Sokol Bashota**, tha se ne kemi shumë kërkesa rrëth vendosjes së këtyre pengesave. "Kemi plot raste, pasi janë vendosur për 3 kam dhënë urdhër për t'u hequr, por koincidoi me kohën kur ishte vera dhe fluksi i qytetarëve të ardhur nga jashtë dhe ndoshta është bërë një gabim që janë vendosur atëherë dhe u vërejt shumë te qytetarët. Por, që, ka nevoja ka, sepse policia ndoshta nuk ka mundësi dhe potencial për të ndërhyrë gjithkund. Mirëpo, të jeni të sigurt se në ato vende ku janë vendosur ka raste të shumta të shkeljeve të njerëzve dhe tash të na thotë ndokush që për një kërkësë më është shkelur familjari, mendoj që na qetë në pozita shumë më të këqija këtë asamble, edhe ekzekutivin, edhe pse ndoshta ne pak do të ndikojmë të vetëdijesohemi për respektimin e shenjave. Nuk paraqet problem edhe për t'i hequr, mirëpo invazioni i qytetarëve është aq i madh për vendosjen e tyre dhe gjithmonë me arsyeshmëri, sepse kanë ndodhur shumë raste tragjike. Përballë këtyre rasteve më mirë e kemi paraparë vendosjen e tyre. Jemi të vetëdijshëm që janë të nevojshme, pasi që edhe efektin e tyre ua dimë", theksoi Kryetari .

**Halil Desku**, tha se të gjithë e dimë rolin e këtyre policëve të shtrirë, mirëpo mendoj se për këtë të vendosin ekspertët e jo qytetarët. "Domethënë qytetari bën kërkësë, mirëpo ku të vihet vendos eksperti. Kam edhe një kërkësë tjetër, për shembull në fshatra, në fshatin ku unë jetoj dhe në fshatra tjerë, unë kam parë që duke e punuar asfaltin kanë punuar kësi policësh shumë të lartë sa që ata sjellin rreziqe shumë të mëdha. Unë i kisha propozuar Kolës, mundësishat ata të shkohet dhe t'i prenë, përkatësisht t'i heq dhe të vendosen këta që të që janë të ndërtuar fabrikisht sipas parametrave të paraparë, dhe profesionalisht se me të vërtetë të fabrikuar e jo të atillë me asfalt se janë shumë të lartë dhe po sjellin probleme", shtoi prof. Desku.

**Sokol Bashota**, sqaroi edhe disa çështje shtesë tematike, përkatësisht vendosjes së këtyre pengesave të vendosura në rrugët e Klinës.

**Tunë Dedaj**, tha se është mirë që pengesat në rrugë nationale të hiqen sa më shpejt, sepse aty është e kufizuar shpejtësia dhe nuk paraqitet ndonjë rrezik i madh. "Po nisemi të shkojmë prej Shtëpisë së Shëndetit për Pejë me urgjencë, bihet në pengesë, në ndesh, Në qoftë se asnjë komunë nuk i ka vendosur, nuk kemi nevojë as ne t'i kemi, se as ne nuk jemi të veçantë. Dhe pajtohem me Kryetarin, pse dy pengesa afër. P.sh. në rrugë për Dollovë janë dy pengesa, dy pengesa janë diku 60-70 metra në largësi njëra me tjetrën. Njëri të hiqet, ndërkaq tjetra të hiqet", vlerësoi anëtari Dedaj.

**Haxhi Ibishi**, tha se ka qenë propozim i AAK-së për interpelancë për këtë punë, po shterojmë debatin kësaj radhe. "Pasi që për momentin nuk prezanton në seancë z. Fadil Gashi, nuk po ia lexoj kërkësën. Z. Bozhidar Sharoviqi kishte kërkësën për sigurimin e lop topve për anëtarët e Kuvendit.

**Sokol Bashota**, tha se rreth kësaj çështje kemi diskutuar më herët. “Jam brenda vendimit tuaj, i cili është i arsyeshëm, por të hyjë si material i Kuvendit ose si material shpenzues. Kërkesa është aktive, edhe unë jam brenda mundësive buxhetore. Ju e dini që për Kuvendet tjera çfarë është thënë për këto lukse, megjithatë vullneti i juaj është i arsyetueshëm, të shfrytëzohet ky investim tamam si material shpenzues”, theksoi Kryetari.

**Haxhi Ibishi**, thotë se anëtarë Skënder Merturi pyeti: a është i pijshëm ujë nga Fabrika e Re? “Përgjigja duhet te merret nga drejtoria përkatëse”.

**Baki Gashi**, sqaroi përgjigjen. “Më shumë se fjalët e mia flasin argumentet. Ne para pëurimit të Fabrikës së Ujit, edhe pse ka qenë nën kompetencat e kompanisë e cila i ka kryer punimet për t'i bërë analizat e tillë, mirëpo ne i jemi drejtuar Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës që t'i bëjë analizat se a është ujë i pijshëm apo jo. Dhe përgjigja nga ta na është kthyer se ujë është i pijshëm për njeriun”, shtoi drejtori Gashi.

**Skënder Merituri**, tha se pse jam drejtuar me këtë pyetje, sepse shqetësimi i qytetarëve është se a pijet apo nuk pihet ky ujë. “Mendoj që është e rëndësishme të dilet Komuna me një komunikatë zyrtare që qytetarët ta pinë ujin. Është e vërtetë se ujët te fabrika pijet, por ujët që po vjen nëpër rrjet, nëpër banesa, qytetarët nuk janë duke e pirë ujët. Unë personalisht e marr ujët në Pejë dhe e blej. Ky ka qenë shqetësimi: a po pihet apo nuk po pihet ujë dhe të dilet publikisht të thuhet. PDK-ja e kontrollon atë dhe të dal publikisht dhe të thotë: Ujët e Klinës pihet, shkurt”, tha anëtarë Merturi.

**Sokol Bashota**, tha se rreth fabrikës së ujit, ujët është i pijshëm. “Dhe, të jeni të sigurt se kemi qenë nëpër lokale dhe kemi konfirmuar se ujët pijet. Ujët nga Institutit Kombëtar i Shëndetësisë rezultatet kanë dalë se ujë është i pijshëm në qytet. Njerëzit akoma shkojnë në Pejë për të bartur ujë sepse është krijuar ajo rutina e bartjes. Tash është “Hidrodrini” që është përgjegjës për të dhe ai në mënyrë të vazhdueshme duhet të vënë kontrollin e ujit të pijshëm, prandaj ujët është i pijshëm”, theksoi kryetari Bashota.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se pyetje tjetër e Skënderit është për dy reklamat në rreth rrotullimin qendër, sepse sipas anëtarit Merturi ka ankesa të qytetarëve.

**Gjokë Lleshaj** (drejtor i Drejtorisë për SHPE), sqaroi çështjen e ngritur nga anëtarë Merturi. “Janë disa paramasa, të cilat janë zbatuar kur janë vënë. Dhe nuk mundet një qytetar ose një pyetje e dikujt që të vendos. Ka disa organe që vendosin. Po që se Policia vlerësojnë se duhet hequr, atëherë, domethënë që duhet të hiqen. Pra, heqja e tyre duhet për ta pasur arsyeshmërinë se për çfarë janë duke penguar, a janë duke penguar në komunikacion, apo ku. Nuk po di qëllimin që çfarë janë duke penguar. Domethënë, nëse policia ose dikush ka vërejtje të arsyeshme, ne e shqyrtojmë këtë mundësi dhe nëse është e nevojshme i heqim”, u përgjigj drejtori Lleshaj.

**Skënder Merturi**, tha se shumica prej nesh kemi leje të veturave dhe haptazi vërehet ajo pengesë. “Është një pengesë që në anën e kundërt nuk e vëren automjetin tjetër që është duke ardhur, po zihet një pjesë e rrugës dhe je i detyruar ta presësh automjetin tjetër për të ecur dhe shumë lehtë vjen deri te aksidenti, ku ka pasur aksidente të vogla, ku ta dimë sa të mëdha. Por që është pengesë është pengesë, nuk di çfarë duhet bërë për të kuptuar se vërtet është pengesë, e para. Dhe e dyta, nëse ata ujë që po thotë Kryetari pihet, pse po na bien ujë Rugove këtu, e s'po na ien ujët të këtushëm për ta pirë”, tha anëtarë Merturi.

**Haxhi Ibishi**, tha se Rasim Millaku pyet se a ka mundësi që të bëhet diçka për lokalitetin e Ujëmirit që të vendoset një stacion policie për çështje sigurie. “Çështja e sigurisë është çështje e nivelit nacional. Sigurisht se Kryetari me Komandantin ka vijën e komunikimit që ka mundësi ta paraqes këtë shqetësim të këtij lokaliteti. Enver Gashi kërkon që të vendoshen shenjat e komunikacionit në rrugën që shpie tek shkolla e Sferkës”.

**Kolë Prenaj**, tha se vetëm ta dimë cilat shenja, nuk është problem. “Cilat janë kërkesat?”-tha ai.

**Haxhi Ibishi**, tha se me propozimin e dy partive opozitare në seancën e shefave të GP me mua dhe Kryetarin, do të merremi vesh si t'ia bëjmë kësaj çështjeje. “Kur i vendosin, minutazhen, hapësirën, nuk mund t'i lëmë 27 këshilltarë, askush s'ka tendencën pér të penguar, mirëpo po vjen pika, Pyetje përgjigje, më e madhe se sa të gjitha të tjerat. Është rregullorja në fuqi dhe vendosim tolerancën e mirëkuptimit mes vete, se nuk ka askush tendencë pér ta mbyllur”, shtoi Kryesuesi.

**Ndue Shabanaj**, tha se me këtë çështjen e pikës, Të ndryshme, dhe në përpjekje pér ta shkurtuar ne e kemi zgjatur. “Edhe kjo më të vërtetë nuk na ka hije kështu, pér shkak se secili prej nesh ka shqetësimë e veta të caktuara. Është mundësia dhe rruga pér t'u trajtuar, pér të diskutuar dhe pér t'u shqyrtuar të gjitha shqetësimet e mundshme përmes pikave të veçanta të rendit të ditës kur ato janë të arsyeshme. Unë nuk e përjashtoj mundësinë pér të pasur ndonjë pyetje, por çfarë pyetjesh dhe çfarë shqetësimi në kuadër të pikës, Të ndryshme. Nëse është aq aktuale sa i humbet aktualiteti pér dy javë ose pér një muaj, unë pajtohem me atë, sa pyetje secili prej nesh ka, 2-3 pyetje, ka 5 pyetje, edhe nga 1 qoftë, kjo është aq e patolerueshme kjo punë sa më e madhe pika Të ndryshme dhe pyetje e përgjigje sa e gjithë seanca. Ishte dashur ta thërrasim arsyeshmërinë tonë personale, e jo pér të treguar sa jam i interesuar përmes pyetjeve këtu, por pér të krijuar mundësinë e procedimit të rregullt edhe më tepër pér të pasur angazhim pér pikat e rendit të ditës, më se paku pér këtë pyetje e përgjigje”, nënvizoi prof. Shabanaj.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se pajtohem dhe në këtë fryshtë në takimin që patëm me kryetarët e grupeve, kështu ishte frysma e diskutimit. “Edhe një pajtueshmëri jona, prandaj ne do të vendosim në seancën e ardhshme, në takimin e ardhshëm, minutazhen, formën dhe atë që kemi thënë, nëse diçka, përkatësisht një teme i del aktualiteti, sikur ka shprehur LDK-ja, siç ka thënë, Shqyrtimi i çështjes në arsim, që propozoi këshilltari me të drejtë, le të jetë arsimi gjithmonë në shtator, domethënë si pikë e veçantë, le të krijohet një kulturë e debatit në shtator, në seancën e shtatorit, kur ka këtu kualitetin. Edhe unë mendoj, ju e dini se si hartohet rendi i ditës me ligj, nga dy institucionet, mirëpo gatishmëria e kryetarit Bashota, edhe imja si Kryesues, ka qenë që zëri opozitar edhe i juaji si tërësi të jetë i pranishëm”, shtoi Kryesuesi. **Vlora Tafilaj**, tha se e përgëzoj këtë iniciativë që po shqyrtojmë pikat, Të ndryshme, sepse dihet që dy vjet sa është ky kuvend, por shqyrtojmë këtë pikë. “Deshalidhëm pak lidhur me çështjen e Grupit të grave asamblistë, që unë e kam marrë udhëheqjen e grupit të grave. I kam dorëzuar dy projekte që një muaj, mirëpo nuk kam asnje përgjigje. Ka bërë kërkësë edhe Marija, edhe Aferdita më duket, mirëpo asnijëherë nuk u jeni përgjigjur kërkësave tona. Po ashtu, pata një çështje tjetër, si mund të qasemi në buxhet?”-, shtoi anëtarja Tafilaj.

**Haxhi Ibishi**, tha se kërkesa e juaj edhe kërkesa e DKA-së kanë qenë në të njëjtën kohë jo nëse kohë me seancën e KPF-së, kanë mbetur pér nëntor, shikojeni kur i keni afatet.

**Skënder Merturi**, tha se unë propozoj që pyetjet t'i bimë të shkruara në seancë, gjegjësisht t'i bimë në KPF dhe pyetjet e shkruara t'u dërgohen drejtoreve të caktuar dhe ata të përgatiten pér përgjigje në njëfarë formë qysh është e rregulluar edhe në Parlament. “Ndahen 20-30 minuta, aty dakordohem prapë dhe mendoj që do të kishte qenë më lehtë nëse shkojmë në këtë mënyrë sa jemi duke shkuar sot pér sot. Fillimisht, kjo është pér drejtorin e Shëndetësisë, a po respektohet orari i kujdestarisë natën pér t'u cilën drejtori ka nxjerrë edhe vendim. Në kontaktet që i kam me disa barnatore nuk zbatohet ky vendim i kujdestarisë së natës, maksimumi është deri në ora 12:00, pas orës 12:00 mbyllen edhe duhet pér t'u thirrur në telefon dhe nëse farmacisti nëse gatishmëri, gjegjësisht është shpirtmirë me të celur barnatoret mund të sigurosh barnat. Dy, drejtori i Financave nuk është këtu, tash jemi në muajin e dhjetë, edhe nuk kemi reportin financier të muajt nëntë, pse nuk kemi raport të financave të muajt nëntë? Tre, cilat janë masat që i kanë drejtoritë përkatëse pér ndalimin e vërvshimeve në Zajm me të cilat janë përballet banorët e këtij vendbanimi me sa e sa vite? A është marrë ndonjë hap që kishte pasur mundësi të paktën pér t'i zvogëluar dëmet e atyre nëse vjen deri te vërvshimi, lutem që të mos ketë, por a janë marrë ato masa? Tjetra, pse Kryetari nuk ka raportuar akoma pér punën e tij që është e obligueshme me

ligj për të raportuar në seancën e KK?"-pyeti anëtarri Merturi.

**Bedri Gashi**, tha se paraprakisht çështjen e kujdestarive dhe të barnatoreve e kemi diskutuar disa herë edhe Kryetari ka lëshuar një urdhëresë mbi të cilën ne tash veprojmë. "Në këtë aspekt çështjetona janë të definiuara shumë qartë. Ne bëjmë orarin me rotacion për cilën edhe aty përfundon përgjegjësia e Drejtorisë së Shëndetësisë. Pastaj janë mekanizmat tjera, një kopje i dorëzohet Policisë, një kopje i dorëzohet Inspektoratit dhe kështu mbarëvajtja e mëtutjeshme nuk është në kompetencë të Drejtorisë së Shëndetësisë", sqaroi drejtori Gashi.

**Kolë Prenaj**, tha se ne nuk është që s'kemi bashkëpunim me DSH. "T'ju them sinqerisht për resurset që i kemi, për aq sa kemi inspektorë, aq shumë kemi punë sa që nuk mund të merreni me mend. Vetë personalisht jam në aksion. Katër net radhazi kemi dalë në terren dhe i kemi bërë proceset, i kemi gjetur të mbyllura, me përjashtim të njërsës që kishte qenë e hapur. Mirëpo ne si organ nuk kemi të drejt me ligj për t'i dënuar. Kemi biseduar me mijekë edhe me barnatore edhe me të gjithë. Si është mundësia më e lehtë ta zgjedhim këtë problem. Kishte qenë një mundësi përpëra, që kisha lultur përsëri drejtorin për ta bërë orarin edhe për të dielave. Se nëse kujdestarohet natën, të dielave të jetë orari i kujdestarive siç ka qenë më parë. Nëse të dielave shkojmë me rotacion siç shprehet edhe drejtori edhe ata e mbajnë kujdestarin që nuk është e kotë pasi që të dielave iu kompensohet se kanë qarkullim të shitjes më shumë, por fatkeqësisht të dielave nuk ka orar dhe punojnë të gjitha barnatoret. Farmacistët janë të shqetësuar edhe për vetveten, pasi që natën janë të shqetësuar nga qytetarët, pasi që kërkojnë ndihmë për barna, por nuk është aty vullnet i mirë për ta mbajtur rendin. Ky problem është çështje më shumë tek shëndetësia, por edhe bashkëpunimi me ne është i nevojshëm. Nuk është se nuk jemi të interesuar për këtë çështje. Me ligj nuk obligon për të qëndruar natën asnjë barnatore", shtoi ndër të tjera drejtori Prenaj.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se dëshiroj që anëtarit Merturi t'i jap një sqarim rreth raportit financiar, se raporti financiar në AK vjen në çdo tre muaj. "Edhe Drejtoria e Financave është në kufijtë e raportimit. Për çështje të raportimit të Kryetarit, ai ka orarin e vet kur duhet t'i drejtohet AK", sqaroi Kryesuesi.

**Bozhidar Sharkoviq**, tha se një kërkësë që kam po e përsëris e kam dërguar edhe më herët në Drejtorenë e Urbanizmit për një riparim të rrëshqitjes në fshatin Dollc, diku 50 metra. "Kjo çështje ka qenë qysh nga dimri i kaluar prandaj kishë kërkuar që kjo çështje edhe pse jemi afër dimrit akoma nuk është rregulluar, ajo rrëshqitje aty. Një pyetje tjetër dhe kërkësë imja, që të bëhet diçka në mbrojtje mbrojtjen e varrezave, fjala të varrezave serbe në qytetin e Klinës. Kërkesa konkrete më shumë shkon për Drejtorenë e Gjeodezisë të dalë aty dhe të vendos pikat kufizuese të pronës që i takon varrezave aty, sepse po shihet se ka kamionë të cilët po hynë në pronë aty dhe po dëmtojnë. Së paku të dilet për t'i shënuar pikat kufizuese të varrezave. Dhe kisha kërkuar posaçërisht nga ju zoti Kryesues që të formohet një komision, përkatësisht një grup punues, që ndoshta së bashku me mua dhe me klerin tonë fetar që të marrin informacione apo të dhëna mbi pronën e uzurpuar të kishës ortodokse serbe, në mënyrë që me të gjithë ata shfrytëzues të vendosim një lloj kontrate mbi vazhdimin e mëtejshmë nëse dëshirojnë ta shfrytëzojnë tokën e kishës serbe. Kemi raste në Gremnik, është një parcelë në Zllakuqan etj. Pyetja ime e tretë, që kam potencuar një kërkësë për familjen Filip Frrokaj, nga Dollci rreth një ndihme financiare", theksoi anëtarri Sharkoviq.

**Baki Gashi**, sqaroi çështjen e rrëshqitjes së dheut në fshatin Dollc. Sipas drejtorit Gashi, drejtoria që ai udhëheq deri me tash një kërkësë e këtillë për rrëshqitjen e dheut nuk e kam, do të shikoj mos është te stafi tjetër edhe pse nuk është në natyrën dhe kompetencën e Drejtorisë së Urbanizmit, kjo më tepër i përket Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente.

**Qamile Qitaku**, tha se desha të shpreh një pyetje, a është menduar apo planifikuar për ndërtimin e një shtëpie të pleqve. "Ndoshta krejt rastësisht pyetja po bie mbi domenin e drejtorit të Shëndetësisë, mirëpo edhe të Bordit të drejtoreve, meqenëse është kërkessë jashtëzakonisht e thekuar nga qytetarët dhe është një nevojë", pohoi anëtarja Qitaku.

**Bedri Gashi**, tha se me marrjen e detyrës një ndër priorititetet që kam diskutuar edhe me Kryetarin, ka qenë edhe kjo çështje e shtëpisë së të moshuarve, por për shkak të buxhetit, duhet një donacion, vendi, lokacioni etj. E dimë që një shtëpi e këtillë është shumë e nevojshme për Klinën, qysh është po ashtu e nevojshme prapë edhe shtëpia për të sëmurët me aftësi të kufizuara mentale”, theksoi drejtori Gashi.

**Ndue Shabanaj**, tha se unë mendoj se pyetjet që i drejtohen drejtorisë nuk kanë nevojë të shqyrtohen në asamble. “Ato që përcaktohen për drejtoritë përkatëse dhe jep përgjigje drejtori përkatës, le të urdhërojnë kolegët e nderuar asamblistë t'i drejtohen drejtorit të caktuar dhe ata t'i marrin përgjigjet. Ato pyetje që janë çështje e shqyrimit dhe shpjegimit për AK, unë pajtohem plotësisht që të trajtohen në Kuvend. Kur t'i shtrohet pyetje secilit drejtor, atëherë ne çka jemi këtu? Realisht nuk po më duket e arsyeshme. Dhe ky është mendimi im dhe herëve tjeter kur fillon kjo do të dal jashtë! - shtoi prof. Shabanaj.

**Pjetër Coli**, tha se unë temën, shqetësimin që kam dashur sot ta diskutoj, por veproj tash në fryshtën e diskutimit të kolegut Ndue Shabanaj, në këtë diskutimin e parafundit. “Edhe nëse ka mundësi kisha pasur dëshirë që të trajtojmë si pikë e veçantë të rendit të ditës në seancën e ardhshme”, shtoi anëtari Coli.

**Haxhi Ibishi**, tha se me mua e ke biseduar, por është çështje procedurash që ju si këshilltarë e keni të drejtën karshi të gjithëve për t'i paraqitur në asamble publikisht thjesht, me Kryetarin, mua, me grupin që jemi aty”, tha Kryesuesi.

**Pjetër Coli**, tha se kjo që u la fare në fund, ku koha e koncentrimit të kolegëve tashmë është i shtetur edhe një pjesë e tyre nuk janë as prezent, prandaj mua po me duket se nuk është momenti për të cilën mund unë të diskutoj.

**Sokol Bashota**, tha se unë jam shumë në dakord që temat që ka kanale për t'i marrë burimin e informacionit të shfrytëzohen jashtë AK. “Nëse nuk merreni përgjigje një herë dy e tri, shfrytëzomëni edhe mua si kryetar për pyetjet dhe çështjet që kanë të bëjnë rreth ekzekutivit. Nëse edhe unë nuk ju jap një sqarim atëherë mund të vijnë këtu. Dhe dy, asamblistët janë të vetëdijshëm se ka tema që mund të zgjasin dy ditë, mirëpo është kur këto zgjatën është edhe rruga e shfrytëzimit të pauzave. Madje unë jam ihtar i asaj që listat për t'u nënshkruar në fund të seancës ose për t'i bërë dy, një në fillim dhe një në përfundim të seancës”, shtoi Kryetari.

**Haxhi Ibishi**, tha se Kryetari po shpreh një gatishmëri që për pyetjet në raste të nevojshme të përgjigjet edhe ai. “Për çështjen e z. Coli mund ta lëmë për seancën e ardhshme, pras po e lëmë për seancën e ardhshme”.

**Skënder Merturi**, tha se në pyetjen që kam bërë rreth vërvimeve në Zajm nuk mora asnjë përgjigje. “A duhet ta bëj edhe një herë pyetjen apo ta pres përgjigjen në seancën e ardhshme?”-shtroi pyetjen anëtari Merturi.

**Haxhi Ibishi**, sqaroi që përgjigja do të jepet në seancën e ardhshme.

**Vlora Tafilaj**, tha se nuk di kush po e lekturon materialin e seancës, shumë prej fjalëve të cilat me gabimet e lëshuara drejtshkrimore fjalëve ua kanë humbur kuptimin.

Kryesuesi falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë. Seancën e konstatoi të myllur. Seanca përfundoi në orën 13:30 minuta.

Procesmbajtësi,  
Mikel GOJANI

Kryesuesuesi i Kuvendit,  
Dr. Haxhi IBISHI

